

Azem Baliaj

Folan e shkruan, me qaq dashuri. si shkrove ti, poet i rrallë, qe mbete Me therrc' n'zema e lot merzie, Lvrit' nji loj', larg lazdrimesh...

Mendimet, mundim po marrin,

Ja, u rritim, udhave te Kesaj bote, Po Kuptojme dredhat e historise...

Do te bej pak zhurme dhe alfabetin shqip

do te them permendesh, qeshtu si ti deshirojel

Ato nuk ishin nota muzikore, Ishin puhize bjeshke e vrrini, Ishin dredheza, qrra, lule bore, Ishin qrome buzesh trandafil!

Krah shqiponje mbi bjeshke, Shqipe vallesh naper troje, Shami me flade Shkuzeni, Lot mali qdhetarish boteve, Tela kujtimesh brenda zemres dridhen. Notat e mallit, rreth Kitarës mbliidhen... Ne notan e fundit zogjta ndalen cicarimat, ishin mpire Krahesh, nuk fluturonin dot...

Balkonet me lule e mashtruan, Me qajar lirie, horizonte, shpres'

Endrrat imazhe te ambla sajuan, Njelloj Kur lind, njelloj Kur vdes!

Papiruse

Poezi

dashurie



Papiruse dashurie

.....

Azem Baliaj

Papiruse Dashurie



Poezi



Papiruse dashurie

Autor: Azem Baliaj

Redaktor: Lulzim Logu, Gjon Neçaj

Recensent: Besart Ramiz Tafaj

Korrektore letrare: Elona Capo

Design & Kopertina: Hekuran Koka



© 2018 Azem Baliaj



PAPIRUS ABSURD

Azem Baliaj, gjithmonë i ka besuar spontanitetit dhe është dëfryer me lirinë e paskaj të ideve dhe mendimeve të tij, të cilat më pas është ngutur t'i ndajë me miqtë e tij më të mirë dhe t'ua rrëfejë të besuarve të zemrës. Ka besuar dhe ëndërruar te fuqia e artit, edhe atëherë kur kjo fjalë ka pasur tjetër kuptim. Shumicën e kohës së vet jetësore, fizikisht është marrë me diçka tjetër, ndërkohë që në mendje dhe shpirt luhej tjetër "lojë", ajo e poezisë dhe e teatrit, dy ëndrrat e sirtarit, të cilat provoi t'i shtyjë dhe t'i jetësojë realisht, pavarësisht mundit dhe sakrificave.

Poet i ndjeshëm, detajist i çuditshëm, romantik dhe me forcë të pashtershme motivesh dhe vrulli metaforik, ai me modesti, por me besim solid, ia ka arritur të dalë përtej çdo gardhi provincial dhe të befasojë me prurjet poetike, si dhe me prozën e shkurtër plot ngarkesë emocionale, por edhe me dramën e komeditë interesante.

Aktor i lindur i humorit, në skena të improvizuara, por edhe në skena dinjitoze, edhe vetë jetën e tij e kalon çdo ditë në filtrin e humorit, duke i dhënë atij efekt çudibërës ndaj stresit modern dhe shpesh, harrimit të artistit në dekorin ndonjëherë mizor të sistemit ku jetojmë.

Nostalgjia tek Baliaj nuk është rikthim pas, por një element që frymon në të sotmen e tij aktive. Fryma, gjithmonë e freskët, erotike dhe finesa e krehjes së vargut, e bëjnë padyshim një poet të kërkuar të momenteve më delikate, kur vërtet kemi nevojë për këndellje shpirtërore. Një papirus absurd, por me fletë të tejdukshme dashurie.

Lulzim Logu





T'PADITËN RREZET

-Vendlindjes-

N'rreze t'diellit
dallosa syt' e tu,
tuj' m'pa amël,
o mall Tropoje!

Mall e dashni
e përjetshme...
mjalt' në shpirt,
jo, nji fjal' goje!

Lissus, 09.06.2017



ITAKA E BEKUAR

-Aktorit të madh, Bekim Fehmiu-

Botës i re rrotull, pa e ditur kthimin,
Penelopës heshtur, besë i kërkove:
Me vekun e pritjes të kaliste durimin,
Dhe po me heshtje, besë premtove!

Në rrahjet e zemrës Itaka e bekuar,
Mallin bluante si bluan misrin mulliri!
Pas aventurës, Ti... Uliks i dashuruar,
Itakën përqafove me flakadan hiri!

Udhëtimin tënd, veç Homeri e dinte.
Të tjerët, shpesh, “mbrapsht” e lexuan!
Lumbardha e djepit, yllësive të printe,
Me lot-lulet e saj... itakasit të bekuan!

Lissus, 27.05.2016



DO VIJË NJË DITË

-Për Azem Shkrelin -

Ti je larg meje...
Unë jam larg teje...
Zemrat “shëtisin”
Vijës së kufirit,
Si në bulevard!

Kufiri në mes,
Si gjarpër i zi...
Me sa krerë,
Rrah’ në dy zemra
Dashuri e mjerë...

Gjarpri veten s’ë ha.
Ne s’na sheh dot...
Nuk do zemra si tonat,
Ai do vetëm lot,
Të mbushen Valbonat!

Unë jam pranë teje!
Ti je pranë meje!
Zemrat OAZ gëzimi,
Shëtisin një jetë...
Bulevardit “Bashkimi”.

Bajram Curri, 16.02.1999



NAIM FRASHËRIT

-Në datëlindje-

Sa paganë, perandorë, papë, mbretër,
pashallarë, sadrazem, udhëheqës,
që gjuhë dhe gen, kishin ilirishten,
folën e shkruan, me aq dashuri
si shkrove ti, poet i rrallë, qe mbete
vëlla i përjetshëm, i vlerë me Fishtën?!
"...Shqipëria paska qenë,
që kur dielli është zënë..."
Dielli i saj të mbushi mall e frymëzim,
për shqipet, thirre... lind në perëndim!

Lissus, 25.05.2017



PA HILE

-At' Gjergj Fishtës (1871-1940)-

Me therrc' n'zemër e lot mërzie
Shqip i the shekullit pa nda,
Rreth e qark kësaj rrokullie
Si Shqipnia i vend nuk ka!

Por, çka dreqin s'na shkoj mbarë
Ç'pezëm pat zemra kur u shpreh:
"Ma mas sodit nuk jam shqiptar!"
Ti, shqiptari ma i madh ndër ne?!

...Dojshe dritën e ditunisë
N'ILIRI t'moçme me mbi,
Mos me i ba hile Shqipnisë
N'daçim kurr' me pas Shqipni!

Me therrc' n'zemër e lot mërzie
T'tham armik e çka s'po di,
Rreth e qark kësaj rrokullie
Shqipet flasin mirë për ty...

Por prap' punët s'po shkojnë mbarë
S'dim' çfar' name na la fjetë...
Thue... n'Shqipni s'ka ma shqiptarë,
Nja si TY kur mujm' me e gjetë?!

Lissus, 12.06. 2009



ASHT' MARTIN CAMAJ

Zhag' zhagiton' po zhagitet,
Fatlum fati, i fam' frenuem,
Paqja parqesh po përzhitet,
Digjet ndurim të paduruem!

Lvrit' një loj', larg lazdrimesh...
Mendimet, mundim po marrin,
Sherret me sherr sherrimesh,
Nafak nisjen, n'nadje ndalin!

Rendin rishtaz, ritmet rendin,
Gjallnojn' gjak' n'gjallni gjogu,
Pruni poeti, pa poter' emnin,
Zgjoje zgjimesh n'zana zogu!

Lissus, 24.09.2017



ABC-JA JOTE

-Mësuesit të popullit, Elez Gashi (1914-1993)-

Historinë imtësisht na shpjegoje,
Me dredhat e saj si leqet e Hotit.
Pas tingullit të ziles, shpresoje,
Se mbrujte te ne, trimat e kombit.

Kur thoshe ti, Shqipëria natyrale,
E hartën londineze quaje arkivol,
Mullinjtë e kohës, egër asaj fjale,
I thoshin -hesht dhe ty, -mos fol!

Ja, u rritëm, udhëve të kësaj bote,
Po kuptojmë dredhat e historisë...
Zemrave na kushtron ABC-ja jote:
Mallkue kush i ban hile Shqipnisë!

Lissus, 20.12.2016



RRNO'

-At Zef Pllumit-

Rrno', rrno', rrno'...
Golgotën trego...

.....

Rrno', rrno', rrno'...
Gjithçka kujto...

.....

Kujtimet tua,
I lexon, i rilexon...
I riu dhe plaku...

.....

I lexojnë e ringjallen
Vinçenc Prendushi.
Hafiz Ulqinaku...

.....

Rrno', rrno', rrno'...
Kurrë, mos harro!

Lissus, 26.04.2017



BARESHA

-Kompozitorit, Rexho Mulliqi-

Kryekanga e melosit arbnor,
Si u lind prej zemrës tande?!
Apo, një za kristal, ëngjëllor,
Të ndezi muzën në kandje?!

Ato nuk ishin nota muzikore,
Ishin puhizë bjeshke e vrrini,
Ishin dredhëza, arra, lulebore,
Ishin aromë buzësh trëndafili!

Kryekanga që ty të dha emër,
E çdo ilir shpirtin me të mbush'
Lindi, pasi hyri thellë në zemër,
Një yll, që quhet Pagarushë!

Lissus, 02.01.2017



MARGARITA FISHTËS
-Mësueses së klasës së parë-

Nesër, me shtatë mars
do vij te varri yt,
me një tufë lule,
si në festën e Abetares.
Do të bëj pak zhurmë
dhe alfabetin shqip
do ta them përmendësh,
ashtu si ti dëshiroje.
Nën ledhet e kujtimeve
zëri yt do jehojë:
bëhu djalë i mbarë,
mësuesen, të nderosh!
Nesër, me shtatë mars
do jem fëmijë i rritur,
nga munda i mësuesve,
thinjur prej mirënjohjeve!

Lissus, 06.03.2017



KUR KËNDONTE DERVISH SHAQJA

-Gjysmërapsodi-

“E lam’ borë, e gjetëm dimën...”

Kur këndonte Dervish Shaqja
N’gur e ndru të shqiptarisë,
Shpirti mbushej, njomej faqja!

“E lam’ borë, e gjetëm dimën...”

Sa herë telat dridh’ sharkia,
Dy kuptimesh Dervish Shaqja
Tha, çka s’thotë kurrë historia!

“E lam’ borë, e gjetëm dimën...”

Thon’ dëshmorët kur kujtohen
Ato fjalë të Dervish Shaqjes,
Në dogana shpesh këndohen!

“E lam’ borë, e gjetëm dimën...”

Mallzharitun hesht shqiptari,
Pret ta mësojë kangën Europa,
N’ “sharki” solo, vet’ Ahtisaari!

“E lam’ borë, e gjetëm dimën...”

Nostalgjive më pyesin do lot...
Të ishte gjallë Dervish Shaqja
A thue, si do e këndonte sot?!

Lissus, 03.12.2016



LAMTUMIRË...

(Në datëlindjen e Bilal Xhaferrit, 02.11.1935-14.10.1986)

-nga Geg Toska, në dy kohë-

.....

-Geg Toska dikur...

...Lamtumirë, vendet e mia,
Që po zhduki dalëngadalë...

.....

-Geg Toska (i Riu):

Lamtumirë, Shqipni e moçme!
S'kam çka lypi ma n'kët' vend.
Po msyj rrugët e përbotshme,
Pa prek' n'tela askërkënd...

Lamtumirë, mretesh' Teutë!
Tash anijet, s'janë me vela.
S'na bje' n'mend se jena t'tut',
Nga e hana, deri te e djella...

Lamtumirë, Gjergj Kastrioti!
Me shpat' tande kam ba njetin.
Nuk jam ma stërnip i joti,
N'mos e rregullofsh pushtetin...

Papiruse dashurie



Lamtumirë, Lidhja e Prizrenit!
Budallëk m'ngjan' besatimi.
Tan' po i bien karadyzenit,
Fjal' andrrash mbet' bashkimi...

Lamtumirë, Ismail Qemali!
Kallxomi edhe Is Boletinit,
Jem kan' trima djal mbas djali,
Sot luftojmë birave t'minit...

Lamtumirë, krejt politikës!
Pa dallim, krahinë e krahësh..
Jena ba "dëshmor" të bindjes,
Për një votë, vdes o rrokatesh...

Lamtumirë, Shqipni e dashtun!
N'deksha un', Ty të ectë mbarë!
Dy Geg Toskat zemërplasun,
Gjallë a dek, mbesin shqiptarë...

Lissus, 02.11.2016



ALO, DEDË...

-Mjekes-aktore, Elida Cangonji-

Alo...! Dedë, eja!
Mjaft u lodhe “Rugëve të bardha”,
po të presin njerëzit,
vitit të vjetër po i mbaron ora...

Eja, Dedë... në fishat telefonike
nga urimet po më dridhet dora.
Iku epoka e shtyllave,
tashmë njerëzit ngrihen akull,
nga çmimet, jo nga bora!

Alo...! Dedë, eja! Të lutem, eja!
Nesër do shkojmë...
në dyqanin e celularëve,
të zgjedhim NJË, nga firmat e reja!

Hesht Deda... hesht shtylla...
kohët të hutuara kanë ngrirë!
Imazhi i parafundit flet, pa zë...
E dashur, zgjidh një sa më të lirë!

Alo...! Dedë! Pse po vonon?!
Eja, kibernetika na fton...

Lissus, 19.02.2016.



TUÇ MAKU

-Aktorit Loro Kovaçi-

Të gjitha rolet nga jeta i “more”,
Në jetë i ktheve më tepër se role!
Sa gjallërisht i interpretove,
Dhe kurrë për to gjatë nuk fole.

Nuk kishe kohë ato t’i lavdëroje,
Nga puna mbushur ditët në ikje,
Gjersa Tuç Makun e “përjetovë”,
E të “pushkatuam” me duartrokitje!

Bajram Curri, 1990



LOKJA

-Aktores, Marie Logoreci-

“Çka të kam ba moj ksollë?!”
Pafajësisht të qante zemra...
Ah, moj LOKJA e “Tokës tonë”
Mbetë idhull për mijëra nëna...

Se, fatin e tyre ashtu të zi...
Madhërisht në skenë e solle.
Ndaj për ty Loke, kjo poezi,
Lindi thjesht si bujari ksolle!

Bajram Curri, 1990



FLAMUR

-Aktorit, Sandër Prosi-

Gërmat që prune në Atdhe,
Ishin flori e shkuar floririt,
Dhaskal Todrin monument e le,
Jo vetëm në ekranin e filmit...

Dhe shpirti atdhetar nuk reshti,
Së punuari për kombin si burrë.
Me Ismail Qemalin buzë deti,
Ngrite kryemonumentin FLAMUR!

Bajram Curri, 1990



RUGOVA

Krah shqiponje mbi bjeshkë,
Shqipe vallesh nëpër troje,
Shami me flade Shkëlzeni,
Lot malli atdhetarësh botëve,
Rreze dielli për sytë e lirisë,
Thep lavdie i krenarisë ilire,
Shpatë drejtësie motit të lig,
Dritë mendimesh n'kuvende,
Flamur n'krye të karvaneve,
Pajtim në prag të furtunave,
Mbiemër për brezat paqësorë,
Krushk fati për dasmë të re!

Lissus, 02.12.2017



FOL, JUTBINA!

-Bardit të Malësisë së Gjakovës, Sokol Martini-

Eposi s'paska datëlindje,
lahuta ka lind mbas tij,
n'zana zanash, zani
-heeej... ka jehue moteve,
e ka mrri deri te na,
historia n'kajde prralle!

Jutbina din diçka...
po s'mun e bajmë me fol',
nuk po e lan' celularët,
kapërthurë, riteve
të globalizmit ahmak
qe s'i bahet vonë për ne!

Poeti thotë (i besoj)
edhe përrallat janë histori,
por breznitë e reja
nuk dojn me dit'...
a ka gojë e za zanash,
me fol dy fjalë Jutbina!

Fol, Jutbina! Pash at' emën!
Se historinë përrallore,
mos folsh ti shqip,
për tokë e qiell, ulurima
zezonash ma vjedhin...
e m'lan' qyqe, pa Epos!

Lissus, 17.12.2017



SOT KËNDUAM BASHKË

-Këngëtares, Fatime Sokoli-

Në valët e kthjellta të Valbonës,
Në flladin ambëltor të bjeshkës,
Në zemrat e Malsis' Gjakovës,
Ndez kënga jote zjarrin e eshkës!

Në smeraldë trojesh, tela çiftelie,
Në ecjen e kombit nëpër histori,
Në bukë, besë, flamur shqiptarie,
Ndez malli ynë dashurinë për ty!

Lissus, 29.05.2016



QESHJA JOTE

-Halil Zenelit, 1951-2015-

Sot mblidhemi të “flasim” me ty,
Të qajmë, të qeshim, të kujtojmë...
Kjo ditë prilli, vjet... sikur u nxi,
Por jeta ecën, nuk të harrojmë!

Gjashtëdhjetë e katër qeshje,
Do i “shfletojmë” sot me kujdes,
Ato, si “numër” i more me vete,
Qeshje pa fund TI le mes nesh!

Nga malli, nëna, djemtë, shokët,
Vëllezërit, motrat, fisnikja grua...
Me kujtime do t'i “prekin” flokët.
Do të vijnë te ne qeshjet e tua!

Mik i dashur, kështu e ka jeta...
Një ditë do të ikim kësaj bote...
Mesi i prillit çdo vit thur’ buqeta,
Dhe na “fton” porsi qeshja jote!

Lissus, 15 prill 2016



DY LOT MBI NJË KITARË

-Kitaristit, Riza Hasandoçi, i cili iku 27 vjeç-

Matem të shkruaj, por nuk shkruaj dot.
Melodinë e muzës, e pengojnë dy lot!
Tela kujtimesh brenda zemrës dridhen.
Notat e mallit, rreth kitarës mblidhen,
Migjen i muzikës, sa herë të kujtojmë,
Melodinë e këputur, rishtaz vallëzojmë!

Lissus, 08.10.2016



NJË NOTË NË PENTAGRAM

-Në kujtim të shokut të klasës, kompozitorit Martin Progni-

Në notën e fundit zogjtë ndalën cicërimat,
ishin mpirë krahësh, nuk fluturonin dot...
orkestruesi i dashur po nisej për në qiell!

Menduam, mos zogjtë “ngatërruan” meloditë,
orkestruar nga ndjesitë tua fisnike?!
Dhe u mallëngjyem prej heshtjes së tyre.

Simfonia e dhimbjes shkruhej nga dora jote,
në partiturat e lotëve tanë që njomen...
një notë përjetësie në pentagram, Martin!

Lissus, 30.05.2016



SHKRIMTARES A.C

Ajo mund të ishte dhe sëmurë,
Ngaqë jeta s'përballon realitetet,
Por, aq kollaj s'do vdiste kurrë,
Kufomë, s'duroi që të mbetet!

Ballkonet me lule e mashtruan,
Me ajër lirie, horizonte, shpres',
Ëndrrat imazhe të ëmbla sajuan,
Njëlloj kur lind, njëlloj kur vdes!

Nëpër dilema dhimbjesh të gjata,
Përcillte ditët, dashuronte jetën,
Që t'i vononte trishtimet nata...
Ajo vrapoi të harronte vetveten!

Lissus, 25.08.2017



GUXIM NË DY KOHË

-Poetit Havzi Nela (1935-1989)-

1...

Ah, Havzi Nela, Havzi Nela!
Më kujtohet, ta bëmë tetë me dy!
Varur në litar, lidhur me tela...
Duartrokita... të mos bija në sy!

2...

Tash, që u këputën tela e litarë...
E bëra dhe unë një “trimëri”!
Me një guxim të madh qytetar,
Bleva “krimet” e tua... në librari!

Lissus, 10.03.2009



NJERËZI

-Poetit, Ndoc Gjetja (1944-2010)-

Me vargjet e tua dikur...
Adoleshent i dashuruar,
U dilja përpara vajzave,
T'u dukesha i zgjuar!

Me quanin aktor, erudit...
Mendonin se dija çdo gjë,
Tek ua recitoja poezitë
Me një frymë, me një zë.

Dhe shpresoja me emocion,
Në poetin bamirës mrekullish:
Mbase, ndonjëra më pranon,
Nga gjithë ky zjarr poezish!

Kur ndonjëherë s'më ecte,
"Dështimet" i qeshja me lot!
Ta dish, faji ty të "ngecte",
Më ndjej... i dashur Ndoc!

Me vargjet e tua dikur...
Vajzave sy më sy u fola...
Besoj... të paktën NJERËZI,
Në zemrat e tyre mbolla!

Të gjitha u dashuruan...
Njëra edhe mua më deshi!
Me ish-recituesin çapkën,
Sot e kësaj dite buzëqeshi!

Lissus, 27.11.2004



MARS

-Shkrimtarit, Vath Korreshi-

Marsi prolog pranvere,
Ndërron gjaku, dëshirat...
“*Haxhiu i Frakullës*” s’beson!

Muajt e tjerë, ashtu si marsi,
S’përbijnë mungesën tënde,
As “*Balada e Kurbinit*”, jo!

“*Dy të shtunat e Suzanës*”
Vetëm në mars rikujtohen...
Dhe përmallshëm puthen!

Gluha e “*Ulkut dhe Uillit*”,
Marseve u shprish me nge,
Duke besuar në përjetësi!

“*Hijet ikin nga malet*”, butë...
Dhe “*Njerëzit e minierës*”
Në mars zbulojnë mademe!

Mars... ekuinoks... ringjallje...
“*Rrugëve të bardha*” pritja,
Zhgënjën si “*Dasma e Sakos*”!

Lissus, 12.03.2016

**V.O Në thonjëza janë disa tituj nga veprat e V. Korreshit si novela,
drama, romane, filma, etj., të “shijuara” prej meje! A.B**



LULISHTARI I LETRAVE

-Profesor, Anton Papekës-

Edhe zilja e shkollës të ngjante ninullë,
kënduar në zërin e munguar të nënës!

Mirëmëngjeset tona si poezi të reja,
shkruar nga sytë tanë plot rreze drite!

Mbillje ndër ne dashurinë për librin,
si “Farëhedhësi” i Onufrit ograjave!

Dhe sa herë mburreshim për lexime,
na zije mat me, çfarë keni shkruar sot?

Në heshtjen fëminore, ëndërruese,
“nuhasje” shkrimtarët e “ardhmërisë”!

Mbete për ne lulishtari ynë i letrave,
dhe dashuria jote ninullë frymëzuese!

Në lodhjen tënde dhe pasionet rinore,
mbinte poetikisht arkitektura e dritës!

Lissus, 19.05.2016



TAHIR BEZHANIT

More burr' i dheut,
një mijë herë kam dasht' me t'pyet:
Qysh ke mujt' me u ba dymijë vjeç
me zemrën e ndame përgjysmë?!

.....

A thue se kohërat
përplasen, lindin vigaj në furtuna;
frymëzohen në errësirë hije malli
dhe i pëlcastin muret e heshtjes?!

.....

Apo leximi i shkrumit,
urtive të Rekës në vite tronditëse,
piskamën e heshtur të themeleve,
e bani dëshirë të çmendur ashti?!

.....

More burr' i dheut,
pse s'kallxon pash' palcën e ashtit;
qysh rrahin dy gjysma zemre n'ty:
a mos, i përkund' e njëjta ëndërr?!

.....

Fol, Tahir Bezhani!... Ndaç piskat!

Lissus, 30.09.2016



HIJE DHEU

*Autorit të librit me të njëjtin titull, poetit Hasan Selimi të cil-
it, të gjithë ne, shoqëria e tij, i thërrasim me dashuri mistike
“Mixhë(a)”...*

Qysh në botën e paardhun
të ndollën magjishëm gjollet e krypuna
me musht jete të lendeve të lisit tokë-qiell...

Mistikën e kapërdimjes kohëve
urtësitë ty ta shpjeguan açik nesh, e ti,
kurrë nuk u serite apologjive andrrimtare...

Deri në botën që ka me ardhë
trokon pak para idhujve, qetësisht, krejt
si bablok i burrnisë t'gurit kala në murime...

Blegërima dhensh, si në përralla,
ta bajnë bystek mallin, qeshjen, lotin, kangën
e rudinat e bjeshkëve lahutojnë bulevardit...

Breznitë rrethaz flasin me djalin,
që plangprishjen e quan krimin ma të keq
mbi dhë e nën dhë, në të tana trojet arbër...

Lissus, 16.03.2016



PËR MIKUN TIM

-Mjeshterin e madh, Ali Mula-

Në telat e çiftelisë, dora jote!
Në vatrat e malsis' hokat tua!
Në valët e jetës, muzika jote!
Në yjet e bjeshkës si një krua!

Në artin e madh, djersa jote!
Në skena përherë si një djalë!
Në humorin tënd, këshilla jote!
Në kujtimet tona mbete festival!

Në rininë e gjatë, qeshja jote!
Në zemër dekadat Ti sfidon!
Në të gjitha udhët e kësaj bote,
Ne, përjetësisht na pasuron!

Lissus, 18.01.2017



LULE THINJASH

-Idil poetik, mësuases Katia Adam -

Vrulli i moshës zë e bie...
S'ka më ritëm si dikur...
Fjalë, gjeste, hov rinie...
Tani "shkelin" gur më gur!

Dhe piklohen me kujtime...
Lule thinjash çdo pranverë.
Ah, të bukurat vegime...
Gurgullojnë pandërprerë!

Lissus, 16.12.2007



URIME MIKES POETE

-Rashidës për datëlindje-

Isha dhe unë aty telegrafisht...
si haiku yt nëpër ne, i ëmbël!

A nuk më pe në buzëqeshje,
në vallëzime, në lot lumnimesh?

Isha dhe unë aty, jam akoma...
harruar në festë pëllumbash!

A nuk më sheh në frymëzimet
poetike që gugatin zemrash?!

Lissus, 28.09.2016



TË FALA DETIT

-Poetit Mehdi Dashi-

Mëngjeseve shoh detin,
Heshtas me të flas...
I bëj “të fala”, me poetin,
Mallin ngremë tallaz!

Ëndrrat tona pulëbardha,
Flatërojnë me poetin...
Përqafohen vala e fjala,
Muza shteron detin!

Çdo mëngjes miku poet,
Zhytet thellësive...
Deti muzës i shton jetë,
Imazh dashurive...

Si qe deti, sapo kthehet.
Shuajmë kuriozitetin...
Si fëmijë naiv rrëmbehet,
Qesh kur flet për detin...

Dita e re, ritet mikluese,
Shpirtit ia rizgjon...
Detin ka shtëpi botuese,
Ku ndjesitë “boton”...

Lissus, 18.12.2017



THIRRJA E HAIKUT

-Poetit Gjon Necaj-

1.

Malli nuk shteron,
kthehet fluturim,
mrizet presin.

2.

Miqtë, frymëmarrjen
e bënë puhizë
në krahë shprese...

3.

Pëllumbat gugatnin,
metrika haiku
thërrisnin poetin...

4.

Qyteti ndryshoi
si format letrare
të trembte lotët...

5.

Mrizet freskojnë
krejt bjeshknajën,
frymëzimet blerojnë...

Lissus, 21.04.2017



AH, KËTO LIRIKAT!

-...sms për Agim Bajramin-

Këto lirikat e dashurisë,
Më të lashta së njerëzimi,
Jetë i japin poezisë,
Zbutin çdo lloj trishtimi!

Anëmbanë kësaj bote,
Dashuria nuk lulëzon,
Po s'u skuq faqja jote,
Nga lirikat që lexon!

Pastaj nisin psherëtimat,
Oh, sa ëmbël e ke shkruar!
Xhelozia nxit' ngacmimet,
Kujt vallë, ia ke kushtuar?

E kupton se është për ty,
Gjoksi nis e pranveron,
Zjarr lirikash ndez me sy,
Me lirikat bashkëjeton!

Këto lirikat e dashurisë,
Hapin gonxhe pambarim,
Porsi vals' i lumturisë,
Muzgjet ylberojnë agim!

Lissus, 27.01.2017



MBETE BOHEM

-Mirënjohje për Myrteza Gjyriqin-

Babën nga Tropoja, nanën nga Përmeti,
Të bashkuar që në kohën e mbretërisë!
Të lindën dy vjet para se të lindte qyteti...
Kalove një jetë mes artit dhe fotografisë!

Na nxisje të lexonim, të bëheshim të ditur.
Na mësoje skermë, muzikë dhe aktrim...
Asnjë nder nga ne, kurrë s'pate pritur...
Edhe sot, ty, një kafe, të duket teprim!

Shkruaje poezi, këngë, miqtë i ndihmoje,
Fotografoje bukuroshet dhe natyrën...
Me vuajtjen tënde askënd nuk rëndoje,
Vetëm heshtje pa “ndryshuar” fytyrën!

Kalove mbi gjashtëdhjetë e gjashtë vite.
Me shpirtin tënd fisnik vadite lule jete,
Ti, peng respekti, edukate, peng tradite...
Bohem linde, bohem ishe, bohem mbete!

Lissus, 14.11.2016



TABLO KOREOGRAFIKE “SHQIPONJAT”
-Koreografit të njohur, Skënder Haklaj-

Në majën e Shkëlzenit bora kurrë nuk shkrin,
As nga dielli me rreze, rreth e rreth kësaj bote,
Si flatra shqipesh bardhësisht, mbi mal ajo rri,
Shkrihet vetëm kur i “thërret” koreografia jote!

Dhe fluturojnë shqiponjat mbi trojet iliriane,
Çdo vatër e zemër gjithëshqiptare gjallojnë,
Porsi valë Valbone vrullojnë vallet tropojane,
Me Sharr’, Korab, Tomorr në një sofër gëzojnë!

Lissus, 14 Tetor 2016



ND JESË

-Lek Shtias, i cili tre muajsh u "nis" nga Mirdita për në Tepelenë, i mbështjellë në një tjegull-

Në burgun e Spaçit erdha vizitor
me miqtë e mi, ish' të dënuar
vite me radhë...

Ata ironizonin yjet e fatit,
qeshnin me lirinë..

Vetëm unë qava... si duket,
ngaqë e kisha për herë të parë!

Rrëshen, 21.05.2011



POETËT IU VIKATIN KOHËVE

-Poetit, Adem Zaplluzha-

Pemën e mbjellë në oborrin e shkollës,
 e këputën të ardhurit në trojet e vjedhura.
 Ata nuk duronin pemën e rilindur, si ABC
 nga mësuesi që tinëzisht e kishin vrarë...
 Pemën, ne e soditnim si ikonë të shenjtë
 dhe ABC-në e kombit e shkruanim në zemër!
 Një ditë, më doli nga shpirti një poezi lule,
 të cilën e mësuan përmendsh moshatarët.
 Pesëmbëdhjetë sa mbusha më thirrën burrë,
 nana më vishte bukur të ndihesha krenar.
 Trojet me poezi një mijë herë i bashkova
 e për vëllezërit e mi poetë, përsëri lotoj...
 Jeta i rrit ëndrrat, kurrë s'ia dhuron vdekjes,
 pa i folë të gjitha, ashtu si vlojnë nëpër muza!
 Pema e mbjellë dikur në oborrin e shkollës,
 aromat i shpërndan trojeve të copëtuara...
 ABC-ja e kombit pret të mbërrijmë te gërma ZH,
 vikama e fundit e mësuesit dridh' dheun...
 Të huajt hedhin vallen e sherravitun në zi,
 që rrënjët e pemës të mos lulojnë bashkim!

Lissus, 25.09.2017



PSHERËTIMA E NXËNËSVE

-Kushtuar bashkëqytetarit dhe shokut të hershëm, mësuesit të historisë, ISA SOKOL MUSTAJ, që u nda nga jeta këtë fillimshkurti, në Bajram Curri.-

Ftohtë, tepër ftohtë në zemrat tona...
Malli ynë për ty u bë psherëtimë...
Mësues i dashur, mos e quaj zhurmë...
Nuk të ka hije të na bërtasësh sot...
Në këtë “orë mësimi” të padëshiruar...
Prej lotëve tanë po mbahet qyteti...
Zilja e shkollës psherëtimën muzikon...
Presim qeshjen tënde të hapë dyert...
Malli ynë, kurrë nuk të vë mungesë...
Dashuria jonë dheun ta bën të lehtë...
Kur do të na shpjegosh temat e reja...
Ftohtë, i zorshëm ky provim në histori...

Homazh nga Lezha, 04.02.2016



PËR ELIZA DUSHKUN

Nëpër ëndërrimet e shkuara huq,
Hollivudin shpesh e imagjinoja...
Veten, krenar' në tapetin e kuq,
Duke marrë "OSCAR" e "shikoja".

Por jeta hapësirat na ngushtonte,
Dhe pse herët, role interpretova.
Çdo lloj duartrokitje më gëzonte,
Si personazh kur qesha a vajtova!

Hollivudi nga mendja s'më hiqej,
Hidhte jeta hapat nëpër dashuri...
Më tepër se unë dikush do "piqej",
Të "pushtonte" botën për Shqipëri!

Zbukurove ëndrrat e mia fëminore,
Si prijëse dasme me tagër krushku.
"More" imazhe nga trojet arbërore...
"Buqetë në Hollivud", Eliza Dushku!

Lissus, 29 Janar 2016



DY TELA

-Poetit lushnjar, Sherif Bali -

Si në Myzeqe, si në Babinë,
Të dy e duam lumturinë...

Të dy mjaltë nga zemrat hoje,
Vargje Lushnje dhe Tropoje...

Fllad fushe, fllad mali...
Do gështenja Sherif Bali!

Kumbulla, molla, po tjetër?
Kujtom' me shalqinj e pjepër!

Shpirtit instaluar "dy tela"...
Fatime Sokoli dhe Vaçe Zela...

Si në Myzeqe, si në Babinë,
Vuajmë dashurisht poezinë!

Lissus, 05.04.2007



PENGU I BABËS

(Pa Shqipëri nuk ka Kosovë-pa Kosovë nuk ka Shqipëri!- përsëriste shpesh gjatë jetës së tij këtë sentencë tragjiko-historike, “buruar” nga dhimbja e madhe mbarëkombëtare e copëtimit të hartës së moçme në Londër 1913... Edhe pse doli partizan 18 vjeç dhe i besoi Bujanit ‘43-’44, punës mbi 50 vjet si idealist për “ndërtimin” e jetës së re, kongreseve madhështore... vetëm me 10 qershor 1999 arriti të rishohë, rikujtojë dhe rishijojë “shpjegimet” e mësuesit të tij dëshmor, Hysni Zajmi dhe urtitë e brezave në odat e kullave malësore. Me 10 qershor 2000 u “largua”... Ishte 122-vjetori i Lidhjes së Prizrenit...)

Në Çabrat, o bir, me thoshte baba,
 shpirti të “bën” fotografi
 edhe në qëllqofsh, larg qoftë, pa sy!
 Mua, ky kujtim më dukej i lashtë...
 babës, mendoja, i ka mbetur “fiksime”,
 siç tregonte... nga viti 1947!
 Dhe ja, viti 2010, pas 63 vjetësh, oh!
 shpirti mallshëm m’u lumturue...
 Unë, si baba dikur,
 në Çabrat... tuj “fotografue”!
 Shpërtheva në lot, nga pamjet që mbeten
 ...në shpirtin e babës, si sot në mua,
 këtë ditë maji e sa të kem jetën...
 Miqtë e mi poetë, vëllezër të një gjaku
 duartrokitën gëzueshëm lotin tim...
 Eh! Ëndrra e babës, përgjithmonë
 breznive, peng dhe trashëgim!
 Tetë fëmijë, një vajzë e shtatë djem...
 as në “partinë e vet” s’na anëtarësoi;
 ...Për PENGUN mbetur “fiksime”...
 Një jetë, më falni, veshët na “shurdhoi”!
Çabrat- Gjakovë, 15.05.2010.



ME ZANIN TAND

-Kangëtarit, Syk Papekaj-

Kthjella e bjeshkëve e rue zanin tand,
Në nd'rrim t'stinëve e ban refren n'mall!

Valbona, çdo vjeshtë, valën e pastër...
Me zanin tand e çon në Gjirokastrë!

"Ç'janë kto gjamë si po i bjen jezeri..."
Fatet e kombit me zanin tand, njiheri?!

Lahutat e çiftelitë nuk rrinë varë në mur,
Me zanin tand bahen bashkë n'flamur!

Në dasmat e reja, kujtimet e ngrohta,
Me zanin tand vlla, ushtojnë në votra!

Lissus, 06.09.2018



KATËR MOSHATARË

Sot, në lokalin "Tradita", festuam katër miq të kohëve, aq të vjetra, sa u "ndamë", pa e ditur kur jemi bërë miq. Ramiz Lushaj, Zenun Hysenukaj, Hasan Selimi dhe Azem Baliaj.

"Thirri" sot "ditari"
Katër moshatarë.
Secili i pari,
Asnjëri i parë!

Gotat me verë.
Zgjonin kujtime...
Sytë plot pranverë,
Vesonin lotime!

Sa fliste juristi,
Thosh' dy rrëfenja...
Tallej pak artisti,
Piqeshin gështenja!

Fliste historiani,
Për të gjitha kohët...
Shterej damixhani,
Për shoqet e shokët!

Papiruse dashurie

.....
Katër moshatarë..
Ditën zbukuruan...
Miqësisë së hershme,
Gazmende i shtuan!

U bënë firmëtarë..
Me zemra, me qeshje.
Katër djem të mbarë,
Bashk' gjer në vdekje!

Me shpirt recitonin.
S'pyesnin ç'thotë bota.
Vargun që harronin,
E gjenin te gota...

Me mall u "ndanë"...
Në bazë të një neni.
Nesër, anëmbanë,
Si miq do t'i gjeni!

Rendin frymëzimet,
Nëpër libra hedhur...
Rishtaz lënë takimet,
Kujtimeve mbledhur!

Lissus, 10.04.2016



PRILL DHE MAJ POETËSH

-Një bejte miqësore me miqtë-

Po vjen maji, prill mos ik!
Të dy jeni shumë poetikë...

Maji vjen, prillin s'ë ndali,
Leje mori nga Sherif Bali...

Prilli iku, majin s'ë priti,
Nuk duron jo, Et'hem Cipi...

Prilli-majit i kreh' flokun,
Haiku qesh me Lulzim Logun...

Haiku ndez porsi eshkë,
Gjon Necaj nëpër bjeshkë...

Prilli ditët kaq i pati,
Do maj Bukurie Bushati...

Prilli në kujtime mbeti,
E qendis Zyra Ahmeti...

Maj, sillti fat këtij vatani,
Po pisket Tahir Bezhani...



Agim Bajrami “proteston”,
Stina detin s’po e pastron...

Viseve lulëzojnë pisha,
Bekuar nga Sejdi Berisha...

Prill-maj “përfiton” i urti,
Flet qetë Muharrem Kurti...

Prill-maj flatron në zemra,
Te poetët, dhjetra emra...

Edhe unë pas tyre rendi...
Ecën jeta, zjarr kuvendi...

Bejten për prill dhe maj...
Redaktoi Viktor Gjokolaj...

Ju uroj shumë lumturi...
Dymbëdhjetë muaj dashuri...

Prill dhe maj jemi ne...
Më “ndërpret” poetja e re!

Lissus, 30.04.2016



XHEVAHIR JA

Kishim një shoqe klase dikur,
Përherë të dashur, të qeshur.
Fjalët i gurgullonin gjith nur,
Kujtimeve, puhizë ka mbetur!

Në fytyrën e saj lodronte dielli,
Në sy hidhte valle dashuria,
Në shpirt një gonxhe trëndafili,
Kish lënë në ruajtje perëndia!

U nda nga kjo jetë krejt e re.
Si nënë fisnike, la katër fëmijë.
Xhevahir i rrallë ish' ndër ne,
Xhevahir i rrallë në përjetësi!

Kur pashë një ditë në ekran,
Vajzën e saj, pa fjalë mbeta...
Trishtimin hodha mënjanë,
Xhevahiret... i ringjallka jeta!

Kishim një shoqe, që mungon,
Sonte trokiti në poezinë time.
Mbase dhe ajo po na kujton,
Për vajzën, rishkruan kujtime!

Tiranë, 18.03.2017



PAPIRUS NË LISSITAN

-1444-

Të jemi mirë me botën...
Me Ballkanin po se po...
Hodhi firmën, ktheu gotën,
Mallkuar, kush nuk do!

Festa zgjati shumë net'
Vera e marsit rri ndezur.
Betimi tash qindra vjet...
Si një papirus ka mbetur!

Me botën të bëhemi mirë,
Të shkrijmë akujt kallkan...
Tash qindra vjet, dëshirë...
E "Papirusit në Lissitan"!

Dhe hesht bota hipokrite...
Nuk mat' ashtu si do zoti...
Shaluar në karvane frike,
Rishkruan papiruse loti!

Të jemi mirë me botën...
Vendosi dikur një vatan!
Mallkuar kush vonon votën,
Për "Papirusin në Lissitan"!

Lissus, 16.05.2016



KUJTIMIT TË CEN HOXHËS

Ditët i përcillnim bashkë, ag e muzg...
Kafet, pijet, qeshjet, borxhet, batutat, librat,
rraskapiteshin me ne, pa orar, pa yje,
pa dekorata, pa kurora false, pa fyerje!

Ditët i përcillnim bashkë, ag e muzg...
Ëndrrat shtonin turne pa përqindje page,
si dialog në vazhdim... ku e lamë? Ah, po,
te “IDIOTI” i Dostojevskit, sa hije i ka!

Ditët i përcillnim bashkë, ag e muzg...
Qytetit nuk i shtuam asnjë njollë, vetëm
xhelozinë e delirantëve që as veten
nuk e honepsnin dot humbur lavdive!

Ditët i përcjellim ag e muzg bashkë...
Në të dy botët që kurrë s’përputhen,
kafeve me pak, pijeve me ngjyra,
qeshjeve fëminore, borxheve pa hile!

Ditët i përcjellim ag e muzg bashkë...
Batutave pa sherr, librave çmimemëdha,
çdo lule e vendosur në kurorën për ty,
vuan përcjelljen... pa e ditur sa të doja!

Lissus, 23.10.2016



PABESIA E ADEM JASHARIT

Erdhëm në jetë si dy bij, dy trima të trollit.
Në fundvjesh të largët të të njëjtit vit.
Ti, ditën e Flamurit, unë natën e Shënkollit.
Dashuria për kombin në të dy njëlloj u rrit!

Por, kufiri gjarpër s'na la të luanim bashkë
As politika intriguese e "kurvës së motit"...
Të dy në ATDHE, te dy "ishim" JASHTË(!?)
Vaditnim besatimin me mjaltin e lotit...

Lodrat, të dy i morëm seriozisht, vëlla!
Dhe duke u rritur, shume gjëra kuptuam.
Na prisnin jetës plot ngjarje të mëdha...
I "hodhëm" lodrat, burrisht u betuam:

Trojet të përçara kurrë më të mos jenë!
Trojet nën një flamur duhen bashkuar!
Une "luftova" me gjithë shpirt në skenë!
Ti fale shpirtin dhe mbete i paharruar!

Vërtet, tash të dyve festat na bashkojnë
Besomë, flas e bërtas si "kryetrim" beteje...
Për çudi, vetëm TY, të përulen, të nderojnë!
E vetmja "pabesi", që më rrit pranë teje!

Lissus, 28 NËNTOR 2016



IMITIM PËR MIRË

-Nga Dritëroi-

1 -

Po, Valbonë...
i tillë qenkam unë!
Paskam marrë
valët e tua të kristalta,
në zemrën kthjelltësi,
për të shpërndarë
rrezet e arta, dritë...
në mbarë shqiptari!

2 -

...Dhe vjen një kohë,
e duke udhëtuar
mes këngëve
dhe vargjeve të mia..
nga valët e tua, kthjelluar...
besoj, bëhet Shqipëria!

Lissus, 05.06.2017



MIGJENI MUNGON ME ARSYE

Sepse trishtimi, marshon në çdo kohë!
Sepse mjerimi, "lulëzon" në çdo kohë!
Sepse dashuria, flijohet në çdo kohë!
Sepse Zenelët, i vrasin në çdo kohë!
Sepse Lukja, shet trupin në çdo kohë!
Sepse misërlegjenda, jeton në çdo kohë!
Sepse perënditë, heshtin në çdo kohë!
Diten e tetë të botës... arsyt, rrëfihen...

Lissus, 13.10.2016



ME NE UDHËTON...

-Shokut të fëmijërisë, Valter Dega (1956-1994)-

Përditë me ne udhëton, Valter,
Ashtu si në lodrat fëminore...
U ndave papritur, at' prag vere,
Por, mallin për ty, dot s'e more!

E le mes nesh, në udhëtime...
E le në buzëqeshje, rrugë, votra,
Çmallemi me ty, në sa kujtime,
Katër motrat tua, i kemi motra!

Dhe shprishim vitet që ikën...
Ëndrrat "ecin" udhës, pa shofer,
Këngët e dikurshme, s'fiken,
"Jepi, mos u ndal kurrë, Valter!"

Sot, mbesa jote tetëvjeçare,
Kur zemra e secilit po të kujton,
Foli, si një princeshë e madhe:
Gjyshi i dashur, me ne udhëton!

Lissus, 14.06.2017



YJET E KULLËS GASHI

Për lirinë edhe një fjalë vlen,
sikur ajo, të jetë e guximshme
dhe me mend, liria s'vonon!

Për lirinë, lindje e vdekje,
takohen stacioneve, pyesin,
njëra-tjetrën a thua sa vlejtm?

Për lirinë, turren ëndrrat e reja
ta vaditin, ta lulëzojnë, ta rritin,
t'ia krasitin zhgënjimet e idhta!

Për lirinë, njëmbëdhjetë yje,
t'kullës Gashi, n'Buqan t'Pejës,
predikojnë bashkim trojesh!

Për lirinë edhe një fjalë vlen,
para gjakut të yjeve të lirisë...
ardhmëria të thotë: Beto hem!

...dhe ta mbajë fjalën!

Lissus, 13.07.2017



FËMIJËT E MOTRËS

-Blerimit, Arbërit, Jonianës!-

Blerim, bleri jeta nga dashuria,
Arbër, yllësi trashëgimie e botës,
Joniana, fisnikëri nga Shqipëria,
U rritën të mirët, fëmijë të motrës!

Shtatë dajat tuaj mburren me Ju,
Tre pëllumbat e motrës së vetme,
Sado nëpër botë, përdit' jeni këtu,
Trëndafila dashurie të kësaj jete!

Lissus, 12.08.2017



KUJTIMET PËR TIRONSEN

-L. K-

Veç duke të parë të lavdëronim,
Jabanxhesh' e bukur nga Tirana,
Si garipat, tinëz të "mallkonim"...
Ah, moj zanë ty të vdektë nana!

Më beso, s'të nemnim me zemër,
Na tradhtonin pak, sytë e goja,
Si e rënë prej qielli ishe, o femër,
Hedhur nga zoti të gëzojë Tropoja!

Jo se s'kishte të tjera në qytet...
Njihnim shumë, me to ishim rritur,
Por, një yll, i lindur në kryeqytet,
Në shteg të ballit na pati goditur!

Miket tona nisën, të qeshin me ne,
Çuna na harruat, kini mendjen pak,
Krejt ju ka trullosur banorja e re...
Ah, kur s'ju lidh' bashkë në një lak!

Kur na buzëqeshje edhe trotualet,
Vallëzonin, me rreze Shkëlzeni...
Tungjatjeta, të uronim si të parët,
Me ty jabanxhesh' të lumtur jemi!

Eci jeta, të gjithë u dashuruam...
Në dasmat tona kcim vendi mësoje,
Por kryedasma ku të gjithë festuam,
Ishte dasma jote, si nuse Tropoje!

Lissus, 16.08.2017



T'PARËS DASHNI

-D. U-

Variacion n'gebnisht

M'paska kput' malli për ty,
Vetmeveti po flas si i marr'...
Fekton sa her' hap e myll sy,
M'ka ter' uja, m'ka ba' zhar'!

Kurrkuj', s'muj me i kallxue,
Shfryj' n'ty pa t'pas përball'...
Kukat' nji za' kuku për mue,
A thue ka dek', a asht' gjall'?

Ti n'kofsh diku n'kët' rrokulli,
Mos prit me ndie zi' për ne...
U kacavarëm n'nji mrekulli,
Vetëm vuejtja, po vdes e re!

Lissus, 23.08.2017



VEKATORJA

-(X. Lushaj)-

Kujtim fëmijërie nga Babina

N'tan katundin, nana Xuf
ish' ma e mira vekatore...
Vekët ku endke qylyma
e sixhade shndritshin...
Bijat e dhanuna larg fisit,
te nana Xuf thurshin yrrnek...
E përkulune mbi vek' gati
e kputke gjumi prej lodhjes...
Prej andrrave e çojshin,
zanat e fmive e lulnajat...
Lulnajat e odave t'burrave
n'gar' për shtrojën ma t'mir'...
Lujshim n'livadhet rrotull
dhe prej vekit e çojshim...
Na sajdiske amël, pa za,
yrrnekin buk' e zemër nane...
Ju bafte mir', fill e n'vek'
se dasmat, prujke vjeshta...
Syve tanë masi u ngijshim
krejt lulnajat fluturojshin...
N'tan katundin, nanën Xuf
kanagjeçe e dasma bekojshin!

Lissus, 15.09.2017



QYTETI I AKUZUAR

*-Kujtimet të Teodor Laços, autorit të dramës së mrekul-
lueshme “Qyteti i akuzuar”, 1981-*

Mbi njëqind vjet
Mitrovica e akuzuar!
Nga miniera e artë
Mbeti peng
I lojnave të fliqta
Të kurvës së motit
E të komshive të këqinj...
Thesaret,
Gjithkush i do për vete,
S’do me ditë tjetri
Në cilin truell
Fle ari...
Për arin, hartat shkërryhen
Kombet coptohen
Vllau me vlla, ndahet...
Harmonia e vonuar,
Ka mbi njëqind vjet
Që e la Mitrovicën
Qytet të akuzuar!
Heshtja vret...
Zani ynë do pak mend
E shumë zemër
Me fol krejt trolli
Shqip... me botën!

Lissus, 30.10.2017



NGA MALLI JUAJ NUK TRETA

-Homazh për Elidona D. -

Ajo rishtaz në vendlindje u kthye,
Motra jonë me kurora mbi krye,
Gulshet nyje gjokseve mbërthye,
Vajtojnë dasmorët zemrash thye.

Pse nusja e re nuk po nusëron?
Pse prindërit, shoqet s'po i takon?
Pse këngët me kuj' e lot këndon?
A thua, dreqfatin e vet po mallkon?

Ajo përshëndet- Mirë se ju gjeta!
Ajo buzëqesh- Kështu e ka jeta!
Ajo qetëson gjithë nënat e shkreta.
-Nga malli juaj, u ktheva, nuk treta!

Prej lotëve tanë nuk po rehatohet,
Prej dhimbjes tonë gati po zgjohet,
Prej marres tonë trime po tregohet,
Në pendimin tonë ajo përjetësohet.

Lissus, 05.03.2016.



HËNA E RESHPJES

Matem...
të flas me hënën,
lutem...
të flirtoj me hënën,
përpiqem...
ta puth hënën,
ngutem...
ta vizatoj hënën,
nistem...
shkallëve
drejt hënës,
shkallëve të qiellit,
në krahët
e dehjes...
mos u lodh,
flet hëna...
...i jam dhënë
Frederik Reshpjes
t'i bëj sfidë,
vdekjes...
Me mua
qetësohej
në ditet e zeza.
I duhet
drita ime
në varreza.

Lissus, 06.02.2018



LUMNIMI I JAREVE

“Oooo, shpirt, sa të du...”
Nisa kangën me e këndu’...
“S’bashku jetën me e kalu...”
Un’ me ty e ti me mu...

“Rreth e rreth Shkodrës jam sjell’...”
Jam habit’ me nota jaresh...
“Njat’ ma t’bukrën e kam zgjedh’...”
Pjalmue n’arom’ petalesh...

Jare, n’pentagrame t’shpirtit...
I madh e i vogël u pat’ këndu’
Me notat tuja, rrezet e diellit...
Botën ftojnë, me dek’ me ju...

“Oooo, shpirt, sa të du...”
N’damar tem’ kur e këndoj,
“S’bashku jetën me e kalu...”
Krejt idhnimet, amël largoj...

“Rreth e rreth Shkodrës jam sjell’...”
Jam lumnue me zana jaresh...
Thell’ në zemër i kam mbjell’,
Se nër’ jare, si ndashni, njallesh...

Lissus, 04.01.2017



SKAMNA E ALUSH ALISË

Ajo ishte aty para fëmijëris' sonë...
 lëngu i saj ilaç nderonte familjen e manave,
 bile manat mburreshin me missin e tyne.
 Ajo kishte "motrat" e veta nëpër Kolgecaj,
 te Arif Mulika, te Shpend Bajrush, te
 Shaban Haxhia, te Selim Braha, te Sokol Mani,
 te Hasan Mehmeti, te Mal Rexhepi, te Uk Syl...
 I donim të gjitha ne fëmijët,
 por skamna e Alush Alisë ishte në qendër,
 harronim shpesh dhe kacavireshim me tesha të reja
 për kokrrat e ambla e të tharta që zgjatnin jetë...
 Alush Alia vetëm qeshte, u rritshi uronte...
 nusja e tij yll, me duar e ftyrë si tamli i deles
 ma kthen përqaqimin fisnik e qeshjen prej nane:
 rujuni, po rrzohi, luani sa të doni, ju paça!
 Skamna plakej e na rriteshim,
 filluam t'i shmangemi bojës që s'lahej
 se mos na ngucnin moshataret tona...
 pse jeni lye ju djemtë si na çikat?!
 Thirrshim të gjatët e qytetit të na i mbërrijnë,
 skamnat ilaçin e jetës, të dashnisë,

Papiruse dashurie

.....

mbi njëqind vjet jete i dhanë Alush Alisë...
Vinin Brahim Gjongeci, Kol Progni,
na e banin qefin, duart i lanin te kroni i Smajl Arifit,
qyteti zmadhohej dita-ditës, skamna lulonte...
derisa erdhi rruspulli i shtetit,
pa pyet' për kartën e identitetit,
përmbysi skamnën që na dha jetë e jetë i dhamë,
e tash kujtimet si skamna janë,
lëng përjetësie në themele rritjesh...
Skamnat e qytetit tim brezni dashurie, emër për emër,
ngjyrosin mallin nën arkitektura moderne,
dhe stërnipat e Alush Alisë, lexojnë çka kam shkruar
për skamnën që m'u kujtue...
si n'prallat na ishte një herë,
ajo moshë mbetur peng në pranverë!

Lissus, 09.04.2017



BLINI I GRISË

-Fisnikut, Zeqir Lushaj-

Kuvende burrash mblidheshin,
Ndërroheshin kutitë e duhanit,
Dyert e zemrave hapur rrinin
Në kullën e Sadik Selmanit...

Udhëtarët ndalonin me dëshirë,
Aroma e blinit i mbushte mirësi,
Dhe një gotë ujë kush e ka pirë,
E ringjall nëpër vite si dashuri...

Mikpritja në breza u përjetësua,
“Kulla asht’ e Zotit dhe e mikut”,
Blini i Grisë muzës time iu kujtua,
Sms, për birin fisnik të fisnikut...

Lissus, 06.04.2017



VAÇE ZELËS

Në kulmin e luftës,
atë shtatë prill
po hynin pushtuesit
brigjet ndjenë rënkime!

Fiks atë ditë, erdhe
me zërin tënd qiellor
të na gjallërosh
me këngë e ligjërime!

Lissus, 07.04.2017



TESTAMENTI I PUSHKINIT

"Mos u ngrys prej dëshpërimit,"

Tepër i ri e pata lexuar...

"Nëse jeta të gënjen..."

Vetë Pushkini e pati shkruar.

"Hesht në ditën e zemërimit,"

E vazhdonte vargun tjetër...

"Rishmëz ditë e gazit vjen..."

Postulat mbetën mbi letër.

Ai vdiq tridhjetë e shtatë.

Unë, hesht' e nuk bëj zë...

"Jeta me të ardhmen rron!"

Dhe kur je gjashtëdhjetë e një!

Frymëzimet djaloshare,

Ndezin stinët në çdo moshë.

"Nga e sotmja shqetësohet,"

Muza nuk përfill lëmoshë!

"Kur gjithçka papritur shkon,"

Bukur e ka thënë Pushkini.

"Për të shkuarën përmallohet!"

Djali, Burri, Plaku, Trimi...

"Mos u ngrys prej dëshpërimit,"

Jetës, me kollaj ia del...

Vjen mesazhi i Pushkinit,

Që flijoi veten, në një DUEL!

Lissus, 18.04.2017

** Vargjet në thonjëza janë të A. S. Pushkin.*



BISEDË ME ISMAIL QEMALIN

Unë nuk e shqetësova, vet' më foli,
Pata fat që një kryeministër më do...
Nga fletët e historisë, ngadalë doli...
Dhe qetë, qetë më tha: Më trego...

U kthye djali nga Franca pa helmuar?
Po, Ati ynë! U kthye më trim se dikur.
Mirë, vijoi, të jeni më të bashkuar,
Në hartën e moçme, vetëm një flamur!

Sepse biri im, në fundin e moshës,
Me gjak shqipen e valëvita në Vlorë...
Por, sherret e kthetrave të botës,
Më lanë me një sy, oh, me një dorë!

Gjumi nuk më merr pa e korrigjuar,
Kufirin gjarpër që trojet TONA ndau...
Ndaj, kam merak për bijtë e bekuar,
Loti mbetur peng, syve sot më shkau!

Të lumtë goja, i thashë si një ciceron...
Shpërthe Atë, mos rri foto nëpër zyra!
Amanetin tënd kush nuk e plotëson,
Do fyejë ATDHEUN, me faqet e ndyra!

Lissus, 28.04.2017.



NJË JETË BASHKË
-Shuke dhe Pjetër Pematit-

Të dy iu afruat shekullit,
Fisnike e kaluat një jetë.
Iu ndoqi mallkimi i dreqit,
Ju... Romeo e Xhuljetë!

Përballuat sa e sa stuhi,
Me zemrat lule dashurie,
Dhuronit përherë mirësi,
Si këshilla, prej perëndie!

Përqafuat paqen bashkë,
Fituat mbi rrathët e ferrit,
Xhuljeta "fjeti" në Pashkë.
Romeo natën e Sh'Gjergjit!

Tiranë, 23.04.2017



MIGENA DASHURON

Xhon Gollsuorth dikur pati shkruar,
Te "Lulet e Mollës", për Migenën...
Vajzën e bukur, vajzën e dashuruar,
Që, nga dashuria e ndërpreu jetën!

E lexonim dhe ndiheshim trishtuar,
Dëshironim të ringjallnim Migenën...
Por, sot në Gjakovë u ndjeva gëzuar,
Migena e lumtur, vazhdonte jetën!

Xhon Gollsuorthit mbeta pa i treguar,
Se libri yt, ka përjetësuar Migenën...
Ama ju miq, s'durova pa iu surprizuar,
"Lulet e Mollës" asaj, i ndritën jetën!

Gjakovë, 17.05.2017



BORXH NJË MOTRE

-F.L (K)-

Gjithmonë bukuritë kanë qenë në shënjestër,
Janë synuar të "përvetësohen" nga të tjerët,
Bukurinë tënde, s'e "fitoi" asnjë "mjeshër",
Dhe mbete miss deri sot, qysh në rini, herët!

Të përplasi jeta me sherre të pakuptueshme,
As sot e kësaj dite s'arrijmë t'i bluajmë dot.
Tani je larg, por vuan ëndrrat e këtushme,
Dhe këto vargje për ty, do të "ndezin" një lot!

Sepse dikur, ne, me papjekurinë e moshës,
Të paragjykuam, edhe pse të kishim motër...
Tani, na merr malli nëpër ecejaket e kohës,
Dhe duam "të lajm' borxh", të ftojme në votër!

Bukurinë tënde e rrëmbeu vetëm një melodi,
Një vuajtje muzikanti, me magjitë e muzikës...
Duke "bekuar" dasmat, me ty ra në dashuri...
Dhe fitoi shpirtin e bukuroshes së Babinës!

Në ditaret e hershme, vitet e ikura shfletova,
Nga kujtimet, fisnikërisht u ndjeva i "detyruar",
Motrës, kur i duhej dashuri, nuk ia dhurova...
Dhe shkrova vëllazërisht, prej teje përqaftuar!

Lissus, 24.05.2017



OQEAN

Qe besa, or Gjergj Fishta...
Me mujt "zullumin" kurrë s'ta ndaj:
Pse s'i le shqiptarët me i thirr'
Deri t'lodhen... derrit dajë?!

Dije mirë or Gjergj Fishta...
Me mujt t'ironizoj, t'baj ibret:
Pse u kallzove shqiptarëve
Si luftohet për ATME e TRULL t'vet?!

Burrnisht po t'thom or Gjergj Fishta,
"Faj ma t'madh" s'ke pas qysh ban,
Te "ishte" për mua, eshtnat tua,
Qe besa, i kisha hedh' në oqean!.

Lissus, 12.06.2009



TË SHKRETËT

-Poetit, Xhevahir Spahiu-

Vizë për në parajsë, asnjëherë
nuk arritën të marrin poetët.
Për në ferr morën shpesh nga Jagot,
injorantët, ministrat, presidentët, shtetet...
Ata, duke u dhënë shpresë
me vargje, të tjerëve...
Mbetën në FERRPARAJSE
të shkretët.
Të shkretët.
Poetët.

B. Curri, 17.04.1995



ËNDËRR EUROPIANE

-Aktore italiane, Antoneta Lualdi. Në filmat që shfaqeshin dikur... si "Më fal", "Kastadiva" etj. e duartrokisnim si të marrë-

Kurrë nuk e kuptove sa të kam dashur,
S'më dalloje në sallën mbushur plot.
Zemra për ty, gati më pati "plasur",
Në kinema "Valbona" tek derdhja lot!

Trishtimet e moshës shpejt më kalonin.
Endrrimtar' në verë e ktheja dimrin...
"Kastadivën" duet, bashkë e këndonim
Egër "rivalizoj" me Vinçenco Belinin!

Dhe në radhën e qumështit flisja për ty,
E largoja gjumin që ti ma kishe prishur,
Oh, imazhi yt më lodronte në sy,
Vinin mëngjeset natën duke grisur!

Linim të shiheshim si dy të dashuruar...
Ti, natyrisht, nuk dije gjë për takimet.
Unë kurrë nuk mungoja se të "doja" ty,
Ty që m'i mbajte gjallë frymëzimet...

Lissus, 15.09.2006.

(Duke ndjekur një spektakël në Tv Klan ku u këndua aria e Kastadivës nga opera "Norma" e Vinçenco Belinit...)



REPORTAZH POETIK

-Dy takime me poetin Din Mehmeti-

Herën e parë, ta dhashë dorën
në Pallatin e Kulturës "DARDANIA"
në qytetin Bajram Curri...
Po përkujtonim Fatime Sokolin.

Ushtonte zani i saj në veshët tanë,
"...Si barut kur qet' vetima
po na vjen Hasan Prishtina..."
E ne, kqyreshim në sy, si dy të ringjallun:

Unë i lumtur që ma në fund të takova.
Ti... i gëzuem që të paskam dashtë!
Herën e dytë, ta dhashë dorën
në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi",

në Gjakovën e dashur, historike...
në një miting të madh poetësh!
Më përqafove. Oh, sa reklamë pata!
Kujtuan të gjithë se edhe unë jam poet!

Dashurinë prap' e thamë me sy...
E tash, që ndër ne me arsye mungon
mblidhemi, poetë të hartës së moçme,
dhe "recitojmë" me ty, Heshtjen e kallur!

Lissus, 03.10.2012



VALLTARJA

U lind dhe vdiq duke kërcyer.
Nëpër dasmat tona "fluturonte".
Një jetë, valltarja e përkryer,
Të ishim të lumtur na ftonte.

Dikush nga ne kurrë s'vallëzonte.
Vetëm kthente gota marrëzie...
Valltaren nën dehje përgojonte,
Rrokatur prej njollash xhelozie!

Një ditë thikën nxori, Otello i zi...
Gjakosi valltaren dhe shaminë!
Dora t'u thaftë! Dasma u ngri...
Nga ai, që s'njihte dashurinë!

Në frymën e fundit ajo kërcente,
Vallja e dasmës të mos ndalojë...
Otello s'më vrau pse më urrente,
Por... ngaqë... nuk di të vallzojë!

Vjen në kujtime si flutur në valle,
Dy pikla lot na i fshin me shami...
O, kalle dasmën, o valltare, kalle,
Nëpër dasma, kërcëjmë me ty!

Lissus, 18.04.2016



ALEKSANDËR LALOS

Gratë e dimrit të fundit mbetën ngrirë.
Miqtë në një tavolinë një gotë pa pirë.
Një talent i ri pret një këshillë të dliër.
Fëmijët duan akulllore nga miku i mirë.
Pentagramet, pa ty ndjehen vështirë.
Meloditë e tua, jetës, i zgjojnë dëshirë!

Lissus, 20.11.2017



LIRIKË LIQENI

-Poetit Dh. Pojanaku-

Një pogradecare
më buzeqeshi
buzë liqenit,
dita sa kish zbardhur!
Më pa të hutuar
pas valëve,
Lasgushit, Kutelit,
tha: qenka i ardhur!
Qesha, gati fola,
por fjala si varkë
lirikave diku ngeci,
të gjithë poetët, o zanë
ndiejnë thellë...
muzë Poradeci!

Lissus, 12.05.2018



QUHEJ BUKURIE

Bjonde me sy bojëqielli,
Qeshjen fabrikë çiltërsie,
Zemrën pastërti dielli,
Gjestet, furtunë dashurie!

Në skenë, aktore brilante,
Luante nënën, vajzën e re,
Nga hiret dilnin diamante,
E donim si një motër, ne...

Por njëri e paska dashur,
Për nuse e kish piketuar,
Nuret e saj kish pikasur...
E duartrokitëm të nusëruar!

Kujtova miken e hershme,
Aktoren e roleve të rralla,
Bukrit' tonë të potershme,
Muza më tha, dërgoi të fala!

Lissus, 09.02.2017



KORRIGJIM

Ali Podrimja, sa "rëndë" paska gabuar,
kur tha: Kosova, gjaku im që nuk falet!
Ai varg, ai betim ende jehon trishtuar...
Lukunia e heronjve të gjallë, egër tallet!

Mbi gjakun e derdhur lulëzojnë biznese,
Lulet, nëpër kurora mjerohen në siklet...
Kur i vendosin kollarexhinjtë për interese,
Në varre a monumente, me pompozitet!

Ai varg i Podrimjes, më lidh' në mendim,
Me amanetin e tij herë hesht, herë guxoj.
Me lot ëndërrshpresë i bëj një korrigjim:
Gjaku im që nuk falet, tradhtarët mallkoi!

Lissus, 22.05.2017



NGA MALLI U HUTUAM

-Suelës-

Në Lissusin e vjetër u takuam,
Kishim mbi dy dekada, bashkë pa u parë...
Si dy fëmijë nga malli u hutuam,
Na vinte për të qeshur, na vinte për të qarë!

Harruam moshën, hapëm ditaret,
Nga vendlindja dhjetra kujtime i shpluam,
Të kaluarën, relike ruajnë mërgimtarët,
Në të gjitha kohët si dashuri të parë e duan!

Valët e Drinit ranë në heshtje...
Si duket u emocionuan nga kujtimet tona,
Ose, turbulluar nga qarje e qeshje
Menduan, po gurgullon në Lissus Valbona!

Lissus, 31.05.2018



PIKËLLIMA

-Poetit, Agim Spahiu (1952 - 1993)-

Pikëllima
po hedh shtat,
përmbi njeri
vallëzojnë trishtimet!

Lotgurët
rreknehen pa fat,
besojnë në ty...
të rikthesh, agimet!

Lissus, 07.04.2018



MJEGULL NË KALA

Kalaja e moçme nën sulme shiu
më humbi prej mjegullës rrethuar,
si në filmat e vjetëruar...

M'u turbullua vështrimi me zezona
luftrash, legjendash, tradhëtish,
sherresh e dashurish...

Më tmerroi mjegulla rreth kalasë,
shiu mbi mure gjuante shigjeta,
s'kish mburojë e shkreta...

U nisa drejt kalasë luftëtar i vetëm,
mjegullën e zezë të shpërndaja,
ecja si trim, si qyqë qaja...

Arrita, syve më fektoi një rreze dielli,
sikur me foli i madhi Skënderbe,
pse kjo mjegull mbi Atdhe?!

Heshta, si në filmat e vjetër pa zë...
kryetrimin asgjë nuk i shpjegova,
mjegullzezën... mallkova!

Lissus, 20.05.2016



PERLAT TUA BIO

-Kompozitorit popullor, Sheuqet Kruja-

“Nëpër fusha, ndër kodrina
Bylbyl kangën rri tuj këndue”
Me kët kangë u ndez rinia,
Ec e ndalu pa e kujtue...

“Ke zanë vend ndër ato rudina
E s’po mundem me durue”,
Më vjen n’mend nji ma e mira,
Ec e ndalu pa e përqafue...

Përveç kangve të dashnisë,
Ganimeten e Dasho Shkrelin,
Ndër jehona të historisë...
I ringjalle bashkë me diellin!

N’traditë t’moçme t’Shkodër loces
Tan çka këndojme sot e ksaj dite,
Shpërnda flladeve të Kosovës,
Dal prej shpirti me muz’ drite!

Nëpër breza perlat tuja,
Si në luftë, si në harmoni
Thonë, muzika: Sheuqet Kruja,
Krejt mall bio, krejt shqiptari!

“Je nji zog ma i mirë ndër tjerë,
Je plot kangë e melodi...”
S’do t’harrohesh asnjëherë,
Nëpër zemra që ndijn’ dashni!

Lissus, 30.05.2018



SERENATA E HËNËS

-Poetit korçar, Skënder Rusi-

Hëna u nis drejt Korçës,
Pa pritur të bjerë nata,
Për gjithë dashuritë e botës,
Të këndojë disa serenata.

Me vargje mbi telat e kitarave,
Hëna zemrat do mbushi,
Si në kor buzët e korçarkave
Do thonë, i thuri Skënder Rusi.

Dhe poetit i prishet gjumi,
Ç'qe kjo melodi ledhatare...
Dashuria rrjedh si valë lumi,
Serenatave, hënë lozonjare!

Lissus, 30.05.2018



MALLI MBETUN PENG

Mramjeve, ndritën e llomës e t'flakadajve të oxhakut,
kulla e Zenun Jahës jehonte nga zani i të birit,
që këndonte për nipin kangë të moçme shqiptare!
Mbasi mixha me Man Arifin, përmendshin për s'di t'satën her'
udhëtimet në Rekë, Junik, Deçan, Pejë, Gjakovë, Prizren...
rrotullojshin mullinin e kujtimeve t'mallit t'pashuem' n'jetë!
Zdritshin lot n'sytë e tyne, krejt t'përhimt', n'kajde shkrumi,
e mixha, me mshef "marren" m'thirrke si t'isha matan' kufini:
bjerma çiftelinë nipash bre, ti thaj' kto musteqe t'lagta!
Man Arifi ndojke buzën n'gaz, dada thurke çorapet e reja,
un' sy e vesh' shkrujsha kangt'...
"...Brahim Sadiki ra n'Gjakovë..."
"...Halit Gashi ni djal' i ri..."
"...Zhuj Selman nuk ban ma nana..."
Mramjeve, n'vitet gjashtdhet', un' nipi i Zenun Jahs t'Babinës,
msojsha hartën e kombit, n'kangt' e kndueme prej mallit peng!
Kur erdhën dritat, llomja e çiftelia duronin zhurmën e radios...
Mullini i kujtimeve s'ndalej tuj blue shpresat e t'nesërmes...
Mixha e Man Arifi ikën n'mall t'udhëtimet t'ri...
Edhe atje besojnë se, lajmet për matan',
nipi ynë... na i lexon, bash qysh deshtëm!

Lissus, 21.06.2017



ADRESAT UA MËSOVA

-Lolës-

Mësojeni një sekret të hershëm,
Kur fillova të lexoj libra së pari,
Përqafoja prindërit potershëm,
I pyesja, ku banon shkrimtari?!

Mes punëve lodhur qeshte nëna,
Kur pyetjen përsërisja papushim,
Mbi qytet, sa herë kalonte hëna,
Të më thoshte diçka kisha besim!

Babai më sillte libra vazhdimisht,
Në lexime dua që të jesh i pari...
Pastaj më premtonte... seriozisht:
Po lexove, do të çoj te shkrimtari!

Lexo e lexo, adresat ua mësova...
Disa kishin ikur, disa ende jetonin,
Të shkruaja, oh dhe unë guxova,
Adresën time të tjerë të kërkonin!

Babai mungon, lexoj dhe për të,
Ai mbeti mësues, përjetë i pari...
Për sekretin, miq, mos thoni gjë,
Ende pyes, ku banon shkrimtari!

Lissus, 17.11.2017



PARA TEATRIT TË PRISHTINËS

Një rigë shiu, si lot i motmotshëm
kishte stërpikë Prishtinën
dhe shkallët e teatrit.
Në shkallën e epërme rrmisht u ula,
mos t'më kaplojë vajtimi,
për shfaqjet e ikura!
Askush nuk po më njihte, e kuptova
dhe heshta si një spektator,
i mbetur... pa biletë!
Kaluan të gjithë aktorët e kohëve,
emër për emër i njoha...
prej zanit të dashur!
I përmenda, si në apel, me mendjen
te Radio Prishtina dikur...
s'di, loti a shiu u shtua?
Mu duk si një duartrokitje frenetike
ai lot-shi vere, që m'i vaditi...
dashnitë e gjallnume!
Para Teatrit të Prishtinës, shpirti im
projektoi pa fjalë, mallshëm...
festivalin e ardhshëm!
Njaj fotografi, si "Mbreti Lir" rrufeve
i fola, vllau jem një shkrepje...
s'kem punë me vdekje!

Prishtinë, 02.08.2014



SHKRIMTARËT E IKUR

Sa janë gjallë,
mes nesh, hutuar
frymëzimeve...
jo, nuk i vlerësojmë!
(i tallim kur kalojnë...)

Pas vdekjes,
pyesim kurioz,
ç'kanë shkruar?
E ngutemi t'i lexojmë!
(veten të kuptojmë...)

Lissus, 15.12.2017



MALL PËR POETEN

Kot, krejt kot,
a muj' me të dvet'
ty moj mike poete,
A thue asht' marre'
me t'marr' malli
për miqtë e ksaj jete?!

E mos me fjet'
pa t'fektue rend'
der sa t'këndoijn' gjeli...
E buzt' me u cokrrue,
si zogjt' n'lis...
thanke Azem Shkreli!

Pra, mallin tem'
e nis' e m'kthehet,
e ma ujcit' pasqyrën!
Krejt kot, poete
a muj' me të dvet',
si e ka malli ftyrën?!

Lissus, 14.09.2017



UJVARË DASHNIE

Mos t'u vijë keq...
 mos t'ju shoh rrudha në fytyrë
 n'ju lagt' si pikël shiu kur bie prej gjethes
 që zogu e culahit n'fluturime,
 kjo ujvarë dashnie që shprazet
 prej shpirtit tem
 e Ju, ju fton me' e durue...

Mos t'ju vijë keq...
 mos t'ju shoh rrudha në fytyrë
 n'ju lagt', si shpresë kthimi a mall ndarje
 që fija e penit i ndan jetave,
 kjo ujvara dashnie qa vallzon
 na shpirtin tem
 e Ju, ju fton me' e durue...

Mos t'ju vija keq...
 mos t'ju shoh rrudha në fytyrë
 n'ju lagt' n'gzim dasme a pabesi vdekje
 që ngat-a-ngat e kan fatlumin,
 kjo ujvarë dashnie që s'ndalet
 te shpirti jem
 e Ju, ju fton me' e durue...

Mos t'ju vijë keq...
 mos t'ju shoh rrudha në fytyrë
 n'ju lagt' edhe kur të mungoj me arsye
 që vrullojnë pa m'pyet mue,
 kjo ujvarë dashnie që s'shterr
 si shpirti jem
 e Ju, ju fton me' e durue...

Lissus, 31.12.2017



TE GRYKA E KAÇANIKUT

Vetëm dy monumente m'u ban' bashkë n'imazhe t'mia,
m'u ban' njish me malet, kërshat, qiellin, diellin e lumin...
n'daçi besomni, n'daçi jo, ishin Idriz Seferi e Pjetër Gaci!

Flladi i lisnajës, flladitke vorret e t'parëve e lulet e mbime
prej andrrave të kadtshme t'brezave që rrmisht luftuen
e mue m'dokej vetja n'llogore tuj pritë urdhnin për sulm!

N'daçi besomni, n'daçi jo, Idriz Seferi... m'thirri n' emën:
shko djalo merru me punë tjera, se me ba luftë asht zor,
mos e huto Pjetër Gacin, sa ta mësojnë shqipet kangën!

Te gryka e Kaçanikut mbeta fillikat n'llogore, pa armatim,
s'mujsha as me luftue, as me këndue si t'mos isha gjallë,
dy monumentet, i luftës dhe i kangës... më lan' pa fjalë!

Lissus, 14.01.2018



MES POETËVE

Buzë liqenit,
në Pogradec,
aty ku Lasgushi
dhe Kuteli
ende meditojnë...

U ula në mes,
foła me të dy,
pagova tri kafe,
i freskova...
me pak Valbonë!

Pogradec, 23.07.2017



VALBONAT E QYTETIT TIM

Fola sonte me Valbonën në Itali,
u çmallëm për krejt Tropojën...
Në bisedë e sipër, për inerci,
për disa Valbona e pyeta Valbonën...

Për miket tona të fëmijërisë,
me emrin e lumit gjatë biseduam,
u dërgonim valët e dashurisë
emër për emër, me mall i kujtuam...

Njëra ishte në Amerikë, sa larg...
dy të tjera në Francën veriore...
tri jetokan në Belgjikë... varg,
katra në Gjermaninë qendrore.

U kënaqëm duke folur në mungesë,
të gjithave lumturi u dhuruam,
asnjëra nuk na “iku” në harresë,
kujtimet me to i freskuam.

Valbona, Valbona... oh, ç’frymëzim!
Kristal në shpirt, mjaltë në gotë,
Valbonat e arta të qytetit tim,
kthjelltësi shpërndajnë nëpër botë!

I thashë Bonës do shkoj në Valbonë,
meqë jam akoma në Shqipëri,
me lule bjeshke do thur një kurorë,
mbi valë Valbone do shtoj dashuri!

Lissus, 05.02.2018



TAKIME ME LEXUESIT

Një endacak më tha, shkruaj për punën.
Një jetim më tha, shkruaj për nënat.
Një prind më tha, shkruaj për fëmijet.
Një pastrues më tha, shkruaj për mbetjet.
Një mjek më tha, shkruaj për ikjen.
Një mësues më tha, shkruaj për injorancën.
Një polic më tha, shkruaj për drogën.
Një akademik më tha, shkruaj symbyllur.
Një ministër më tha, shkruaj për tenderat.
Një prostitutë më tha, shkruaj për varfërinë.
Një biznesmen më tha, s'kam kohë të lexoj.
Një lypës më tha, shkruaj për dashuri.
Një miss më tha, vdeksh frymëzimeve.
Një emigrant më tha, shkruaj për adresat.
Një aktor më tha, shkruaj për lotin.
Një analist më tha, s'e njoh Shqipërinë...

Lissus, 07.02.2018



PUSHKINIANE

Në fillim shtigjet e blerta,
na ftojnë jetës me lazri,
nëpër vrullet e poterta...
ndihemi vrullshëm, rini.

Pastaj, shtigjeve të sarta,
shfaqet lodhje në udhëtim,
mundimeve veson djersa,
ndalojmë për pak pushim.

Vonë, shtigjet errësohen,
bëjnë bilanc thinja, rrudha,
shtigje të reja ndriçohen,
hapat tonë freskon udha!

Lissus, 15.02.2018



POETJA BJONDE NË SHI

-R. B-

Shiu Prizrenin e kishte mjegulluar,
Natyrisht, ndodh me shumë qytete.
Një bjonde po kalonte e lumturuar,
Pa çadër, vetëm një libër me vete!

Si duket, nga frymëzimi e pushtuar,
Bjondina e bukur ndihej mbrete...
Nuk durova, u turra për ta takuar,
Mos, më tha shiu, ajo është poete!

Me romantikën e shpirtit djaloshar,
Shijova “delirin” e saj, hutuar në shi.
Bjondina thirri: Eja, o djalë i mbarë,
Prizreni në çdo kohë buron poezi!

Lissus, 20.09.2017



ARTISTËVE TROPOJAS

Putha skenën e dashur
me mallin e netëve zgjuar,
dritat e saj rri ndezur
si dashuri e pashuar...

Kujtimet, si mbyllje sipari
natyrisht, një nga një fiken,
rizgjoheh jetës nga zjarri
i mallit të miqve që ikën...

Publiku, udhëve të botës
akoma na do, na duartroket,
ringjallin yjet e Tropojës
në mallin e vatrës që i pret!

Lissus, 08.12.2016



VJEN ME KËNGËN TËNDE

Natyra t'fali ma t'bardhë se bora...
Ti, kënga e kaçurrelave pse vjen?
Ledhatimet e saj me vete i mora,
Puthjet i mbajti, më nuk m'i kthen!

Iku e re, lotët kortezhin vajtonin...
Dhe unë, si të tjerët, isha bërë dru,
Brenda meje imtësitë tona jehonin,
Buzëtharë këndoja kaçurrelat e tu!

Të lamë vetëm me "miq" të tjerë...
Qyteti s'bzante, shtangur, hutuar...
Çdo dhjetor ti vjen me pranverë...
"Kaçurrelat e tu", duke belbëzuar!

Natyra t'fali ma t'bardhë se bora...
Ti kënga e kaçurrelave pse vjen?
Ledhatimet e saj me vete i mora,
Puthjet i mbajti, më nuk m'i kthen!

Lissus, 19.12.2016

.....
FJALET E TEUTËS

Sapo zbriti nga anija,
Për një kafe në vetmi,
Plagosur nga dashuria,

Tretur nga disa lakmi!
Hedh sytë në filxhan,
Pasi hurp' kafen' me pak,
Shikon sherre në Ballkan,
Ilirinë dashkan, në lak!

Gjithë eskorta vështron
Mbretëreshën e hutuar,
Çka Teuta, që mendon,
Mos kafeja që helmuar!

Mes Durrësit, e vendosur
Edhe sot rri e trishtuar...
Mbretëreshë e armatosur
Ende s'të kemi kuptuar!

Trishtimi i Teutës flet...
Flet e zeza e filxhanit...
Shqipërinë, ka mijëra vjet...
Vrasin sherret e Ballkanit!

Hesht anija përmbi valë,
Pret Teutën dallgëzuar!
Brigjeve vrapon një djalë,
Një kafe për të paguar!

Krishtlindje, 2016



ISHIN FLORI

Ishin flori e shkuar floririt,
Artistët, yje që ikën në vite...
S'i vë dot emrin më të mirit,
Nderim ty, o truall që i rritë!

Qysh me dilemën e Hamletit
Luajtur e vuajtur në Vjenë...
Udhëtimin e Ulksit rreth detit
Brenda vetes kishin Odisenë...

Kishin ëndrrën flori mbi flori,
Të shtonin vlera shqiptare!
Së gjalli nuk gëzuan lavdi...
Lavdia i ndoqi në varre...

Trishtim na shton çdo ikje,
Çdo mungesë floriri në skenë,
U dhamë vetëm duartrokitje,
Të vetmen pasuri që do kenë!

Dhe ikin, dhe ikin e s'kthehen,
Në shfaqjen e re, pa dëshirë...
Florinjte, të fyer do ndihen...
Nga malli i një fjale të mirë!

Lissus, 26.12.2016



549 "MUNGESA"

N'za t'kam njoft' o vllau jem'...
Kur m'kie thirr' n'dit' e n'vjet...
Si bylbyli që k'ndo n'gem...
Lshova zanin me t'amlin njet!

E kur bashk' zanat jehuen...
Gur e dhe, zogjt', hyjt' e ujt...
N'krejt kët' rrokulli kushtruen:
Kurr' na, keq s'i kem ba kujt!

Sa t'fillohet kanga jon' dlor'...
E t'përcillet ndër amanete...
N'lulnim' t'stinve nji dëshir',
Ka me rrit' bylbyla n'djepe!

Rrokullia ka me' met' ngri'...
Ka me fol' n'pasqyra t'thyme:
Te â e hershme kjo melodi!
Ka m'e lyp, n'harta t'shkyme...

Ka m'e gjet dej n'rraj t'fella,
Pse na t'dy', k'ndojm njilloj?!
Fill ka me'u kthjellue qella...
N'nji gjuh kanga do t'pjalmoj!

Lissus, 17.01.2017



DASMA SHQIPTARE

Valle prej Rugove,
Iso prej Labërie,
Bilbil' prej Kolonje,
Lahutë prej Malsie...

Rapsodi nga Hasi,
Shota nga Prishtina,
Curle nga Librazhdi,
Sytë nga Janina...

Serenatë korcare,
Shqipe tropojane,
Vrullet tetovare,
Ah, jare shkodrane...

Potpuri beratase,
Kumuri elbasani,
Shamia tiranase,
Diell dasmën bani...

Ninull' Çamërie,
Shkupin e përflakë,
Vallzim dashurie,
Me një ulqinake...



Dibra qet kushtrim,
Mitrovicën thrret,
Mirditë e Kurbin,
Kangën e kan' njet...

Hov vallja kuksiane,
Hov saze Permeti,
Hov cuca matjane,
Hov Mali dhe Deti...

Muzikë gjakovare,
Vlora me flamur,
Dasma shqiptare,
Nuk ndalon kurrë!

Lissus, 08.05.2017



TË PIMË BIRRËN E PARAFUNDIT

Ejani miq, të mblidhemi në diell...
Të ngrohim kudo shpirtrat e sflitur...
Ta ndejmë veten, yje nën qiell...
Të qeshë me ne tokë e zhuritur!

Ejani miq, me diellin të shkrihemi...
Artistë opozitarë a nuk jemi ne?
T'ia themi troç, me të, të grindemi:
Pse fort shndrit' e tepër pak nxe?

Ejani miq, nuk jemi hijet e askundit...
Kjo botë, një ditë do të na kuptojë...
Të pimë tok, birrën e parafundit,
Dehur lumturie, bota të na bekojë!

Lissus, 25.01.2017



12 NËNTOR 1987

Në vitin 1999, në 100-vjetorin e lindjes së poetit, pata shkruar poemën "Lasgushi fajtor", që u botua në librin tim me lirika "Helmuar nga dashuria", 2002 e më vonë, 2007, në gazetën "Nacional" ... Kurse sot...

Tridhjetë vjet
pa Lasgush Poradecin,
nisen vargjet tona
diku valëve mbesin...

S'duan të zhurmojnë
kur ti mediton...
heshtja e liqerit
mallin... komponon!

Lissus, 12.11.2017



10 QERSHOR 2000

Mbuluar me flamur dhe mall malsie,
na përshëndete për herë të fundit
në ditën e Lidhjes Shqiptare...

Amaneti yt, as lutje, as gjamë as vaje,
fëmijët të mos ndalojnë lojën, pasi
dua të më kujtojnë të gjallë...

Tetë pasardhësit tu i le në provimin
e zorshëm që emri yt t'përmendet
përtej vajzës dhe shtatë djemve...

Mbi varrin tënd gjelbërimi i Babinës,
si ninullat e nan' Zyles të përkund
dhe lulëzojnë ëndrrat breznive...

Këshillat e tua vendosin gur edhe sot,
në themel të ecjes tonë, nën hapat
që dridhen çdo vitmir kujtimesh...

Papiruse dashurie

.....

Vështirë e patëm atë ditë të pajtonim,
moshatarët e tu të mallëngjyer...
pasha besën u thamë... Mbahuni!

Kur u kthyem nga varrezat... fëmijët
po thurnin një kurorë për nesër
dhe cicëronin: kthehet, kthehet...

Mbuluar me flamur dhe mall malsie,
kthehesh me skuqjen e qershive
qershoreve, ditën e mosharrimit...

.....

Babë, pa të marre leje thura një poezi,
persiatjet çapkëne u frenuan vetiu
nga një lot i djalit të "mbrapsht"...

Lissus, 10.06.2016



INSTIKT VETMIE

-Pjetër D.-

Në lokalin "Millenium" një kafe,
 vetëm... pa Pjetër Dedën...
 menaxherin e pallatit tonë,
 me të cilin "grindeshim" përditë,
 për ashensorin, për defektet,
 për shkallët, dritat, ujin, pastrimin...
 Flisnim për ndërtimet, fëmijët,
 birrën, femrat, udhëtimet, humorin...
 Në lokalin "Millenium" një kafe,
 vetëm... pa Pjetër Dedën...
 ka një javë që iku në moskthim,
 pesëdhjetë e dy vjeçar...
 kumont e katedrales jehuan sot,
 unë, për mikun e munguar,
 bana kryq nën dy pika lot...
 për shpirtin e tij në parajsë,
 (nëse ka (!) vende bosh aty)
 se, bosat po e blejnë paradhanie...
 Në lokalin "Millenium" një kafe,
 vetëm... pa Pjetër Dedën...
 fshina n'idhnim pikat e lotit...
 Të gjithë jemi njëlloj para Zotit!

Lissus, 24.06.2018



98 VITET E TUA

-Shaban Adem Rrustajt-

Përcollëm ma t'moçmin e Babinës,
Njëqind, pas dy vitesh do festonte,
U drodh nga malli, bari i lëndinës,
Kur të ikurit para tij, nisi të takonte!

Me shpirtin e bardhë porsi plisat...
Do flasë me babinasit që e pritën,
Harmoninë e fëshfërimave, lisat...
U linin amanet, brezave që rritën!

Lissus, 01.07.2017



TEATRI I QYTETIT TË VOGËL

...i marrtë dreqi andrrat!
 Thonë se zgjatin jetën.
 Unë them afrojnë pleqërinë,
 i çojnë peshë dëshirat kot
 dhe trishtojnë të përditshmen!
 Mbrëmë, skena teatrore
 e qytetit tim të vogël ku u rrita,
 më rishfaqti dhjetra drama
 të duartrokitura rrmisht...
 Kalonin miqtë e mi aktorë,
 me dorë në zemër duke përshëndetur,
 të emocionuar nga emocioni i publikut
 që respektonte "lojën" e jetës së vet,
 interpretuar prej nesh para tyre...
 Qante dhe qeshte spektatori.
 Problemet as në skenë nuk mbaronin.
 As ëndrra ime nuk i zgjidhte dot!
 Pak minuta ishim më të mirët e botës.
 Më të mirët e botës së qytetit të vogël.
 Aktorë të paparë, karaktere të rrallë.
 Të nesërmen respektoheshim
 në radhën e mishit, qumështit, rrugës...
 ...i marrtë dreqi andrrat!
 "Koha për t'u zgjuar" ... gazetata,
 rrezja e të përditshmes një skenë e re!
 Pse u "zhdukën" miqtë e mi?
 Sali Doçi po bluan shfaqjen e radhës...



Gjelosh Marku iku herët te arti tjetër,
Po u qendis këpucë roleve të reja...
Cen Hoxhën e lodhi kolla dhe humori...
Hysen Syla rigjëlberon qytetin...
Rexhep Neza na kreh' me kujdes...
Hysni Hajdarmataj improvizon diçka...
Beqir Bala ka dy vërejtje për regjinë...
...i marrtë dreqi andrrat!
Dramë e re brenda meje...
Nuk duartrokas, tekstin e harrova,
miqtë e munguar më flasin
se di se nga cila botë... jeto!
Jeto edhe për andrrat tona...
Qyteti i vogël na duartroket
edhe pse e përditshmja ndryshon
e rolet tona të "detyrojnë" me nem'...
...i marrtë dreqi andrrat!
Andrrat kujtime, memorial i lotit!
Heronjtë e skenës teatrore
në dramën e përjetshme,
"Morali i kotkotit!"

Lissus, 07.02.2016



NË GJAKOVË

Sa herë shkoj në Gjakovë,
malli kompozon ninulla djepi
dhe përkund brigjeve të Erenikut
dashurinë e vrarë të breznive
të ikura, të ikura, të ikura...
duke përmendur pragparajsën
në grahmën e mbrame të jetës
si lutje drejt qiellit... Zoti ynë,
nesër jam për Gjakovë!

Sa herë largohem nga Gjakova
malli ndez trumpetat e festës
dhe lulnon brigjeve të Erenikut
dashurinë diell të breznive
të reja, të reja, të reja...
duke përjetuar vetë parajsën
në riskun e vazhdimit të jetës
si dhuratë prej qiellit... Zoti ynë,
përditë jam në Gjakovë!

Gjakovë, 19.03.2016



MOTRA E VETME

Dallëndyshet shkojnë e kthehen,
Nga Shkëlzeni drejt Detit Jon...
Mallet, flatrave rrëmbehen..
Dielli i jetës, çdo stinë bekon!

Shtatë vëllezër, ty, fort të duam,
Jo pse je një motër e vetme...
Dashurinë kurrë s'ta harruam...
Në zemrat tona, si zanë mbete!

Në dasmën tënde ne këndonim,
Hidhnim valle... tinëz dhe lot...
Dashurisht, me shpirt uronim,
Lumturinë, me një sarandiot!

Për ty, secili, në secilën votër,
Thur' folenë për dallëndyshe...
Eja motër, shtatë herë motër...
Vonoj pak se, jam bërë gjyshe!

Dallëndyshet shkojnë e kthejnë,
Deti Jon, njësh me Valbonën...
Idromenon, flatrave zbërthejnë...
Dhe bekojnë, për "Motër Tonen"!

Lissus, 09.09.2018



MË THOSHTE GJYSHI

-Taip R. Haxhia 1900-1983-

Të bëhesh i mirë, e vështirë,
Të jesh vetvetja, do kujdes...
Të bëhesh i keq, e pështirë,
Të jesh fals, së gjalli vdes!

Të duash pa hile, sakrifikon,
Të urresh, mjerë kush urren,
Të dhurosh nder, nder fiton...
Të bekosh, kudo veten gjen!

Lissus, 14.09.2018



SMS NGA DANTJA

U ngjita në katin e trembëdhjetë,
Të shijoja një kafe dhe panoramë,
Hodha sytë tej detit si mbi gazetë,
Imazhi, solli një SMS nga Dantja...

...Sapo ngjite të trembëdhjetë katet,
Të pash' veshur hollë, vetëm ishe,
Në ngjitjen e qetë zbukuroje fatet,
Në çdo kat shihje nga një Beatrice!

Dhe më kujtove mua mendueshëm,
Nëpër "Komedinë Hyjnore" vrapove,
Psherëtime një grimë trishtueshëm,
Sikur, timen vuajtje dhe ti përjetove!

Pije kafën e vetmisë bashkëkohore,
Mos e ndiq fatin në Ferr a Purgator,
Mijëra Beatrice shtohen orë pas ore,
Në Parajsë nuk arrin asnjë dashnor!

Sepse dashuria nuk është gazetë,
Që pasi e lexon, e bën shuk, e hedh,
"Katet" e saj, janë mbi trembëdhjetë,
Beso në provën time... nuk ta dredh!

I ktheva përgjigje me detin, pa fjalë,
Nje gulç melankolie në fyt u lidh lak,
Tepër lart qenke ngjitur, more djalë...
Foli Beatriceja e shërbimit, në banak!

Lissus, 09.97.2018



FRYMËZIM NGA KIPLING

-Tim biri, Fisnikut-

Nëse më merr malli për ty, biri im,
Ti, mos u mërzit pse nuk ke letra!
Kjo botë përpiqet të ketë zhvillim,
Por nuk u ikën sherreve të vjetra!

Nëse gjithë bota ty do të përkrahë...
Nuk llastohem, por botës në miting,
Do i thosha hap zemër dhe krahë,
Dëgjoje një poezi të njeriut Kipling!

Nëse kjo botë ka sy, veshë e mend,
Besoj nuk do urrejë më asnjë njeri...
Planeti për secilin ka dy metra vend,
Liria frymon në shtatë miliard Liri...

Nëse të merr malli për ne, biri im,
Për kurrfarë vule, betohu, mos vuaj...
Nëse bota prej teje do përparim,
Me fisnikëri ilire: Tungjatjeta, thuaj!

Lissus, 02.01.2017

.....

PËRMBATJA	
<i>PAPIRUS ABSURD</i>	3
<i>T'PADITËN RREZET</i>	5
<i>ITAKA E BEKUAR</i>	6
<i>DO VIJË NJË DITË</i>	7
<i>NAIM FRASHËRIT</i>	8
<i>PA HILE</i>	9
<i>ASHT' MARTIN CAMAJ</i>	10
<i>ABC-JA JOTE</i>	11
<i>RRNO'</i>	12
<i>BARESHA</i>	13
<i>MARGARITA FISHTËS</i>	14
<i>KUR KËNDONTE DERVISH SHAQJA</i>	15
<i>LAMTUMIRË...</i>	16
<i>ALO, DEDË...</i>	18
<i>TUÇ MAKU</i>	19
<i>LOKJA</i>	20
<i>FLAMUR</i>	21
<i>RUGOVA</i>	22
<i>FOL, JUTBINA!</i>	23
<i>SOT KËNDUAM BASHKË</i>	24
<i>QESHJA JOTE</i>	25
<i>DY LOT MBI NJË KITARË</i>	26
<i>NJË NOTË NË PENTAGRAM</i>	27
<i>SHKRIMTARES A.C</i>	28
<i>GUXIM NË DY KOHË</i>	29
<i>NJERËZI</i>	30
<i>MARS</i>	31
<i>LULISHTARI I LETRAVE</i>	32
<i>TAHIR BEZHANIT</i>	33
<i>HIJE DHEU</i>	34
<i>PËR MIKUN TIM</i>	35
<i>LULE THINJASH</i>	36
<i>URIME MIKES POETE</i>	37
<i>TË FALA DETIT</i>	38
<i>THIRRJA E HAIKUT</i>	39
<i>AH, KËTO LIRIKAT!</i>	40



<i>MBETE BOHEM</i>	41
<i>TABLO KOREOGRAFIKE "SHQIPONJAT"</i>	42
<i>NDJESË</i>	43
<i>POETËT IU VIKATIN KOHËVE</i>	44
<i>PSHERËTIMA E NXËNËSVE</i>	45
<i>PËR ELIZA DUSHKUN"</i>	46
<i>DY TELA</i>	47
<i>PENGU I BABËS</i>	48
<i>ME ZANIN TAND</i>	49
<i>KATËR MOSHATARË</i>	50
<i>PRILL DHE MAJ POETËSH</i>	52
<i>XHEVAHIRJA</i>	54
<i>PAPIRUS NË LISSITAN</i>	55
<i>KUJTIMIT TË CEN HOXHËS</i>	56
<i>PABESIA E ADEM JASHARIT</i>	57
<i>IMITIM PËR MIRË</i>	58
<i>MIGJENI MUNGON ME ARSYE</i>	59
<i>ME NE UDHËTON...</i>	60
<i>YJET E KULLËS GASHI</i>	61
<i>FËMIJËT E MOTRËS</i>	62
<i>KUJTIMET PËR TIRONSEN</i>	63
<i>T'PARËS DASHNI</i>	64
<i>VEKATORJA</i>	65
<i>QYTETI I AKUZUAR</i>	66
<i>NGA MALLI JUAJ NUK TRETA</i>	67
<i>HËNA E RESHPJES</i>	68
<i>LUMNIMI I JAREVE</i>	69
<i>SKAMNA E ALUSH ALISË</i>	70
<i>BLINI I GRISË</i>	72
<i>VAÇE ZELËS</i>	73
<i>TESTAMENTI I PUSHKINIT</i>	74
<i>BISEDË ME ISMAIL QEMALIN</i>	75
<i>NJË JETË BASHKË</i>	76
<i>MIGENA DASHURON</i>	77
<i>BORXH NJË MOTRE</i>	78
<i>OQEAN</i>	79
<i>TË SHKRETËT</i>	80
<i>ËNDËRR EUROPIANE</i>	81
<i>REPORTAZH POETIK</i>	82

Papiruse dashurie



VALLTARJA	83
ALEKSANDËR LALOS	84
LIRIKË LIQENI	85
QUHEJ BUKURIE	86
KORRIGJIM	87
NGA MALLI U HUTUAM	88
PIKËLLIMA	89
MJEGULL NË KALA	90
PERLAT TUA BIO	91
SERENATA E HËNËS	92
MALLI MBETUN PENG	93
ADRESAT UA MËSOVA	94
PARA TEATRIT TË PRISHTINËS	95
SHKRIMTARËT E IKUR	96
MALL PËR POETEN	97
UJVARË DASHNIE	98
TE GRYKA E KAÇANIKUT	99
MES POETËVE	100
VALBONAT E QYTETIT TIM	101
TAKIME ME LEXUESIT	102
PUSHKINIANE	103
POETJA BJONDE NË SHI	104
ARTISTËVE TROPOJAS	105
VJEN ME KËNGËN TËNDE	106
FJALET E TEUTËS	107
ISHIN FLORI	108
549 MUNGESA	109
DASMA SHQIPTARE	110
TË PIMË BIRRËN E PARAFUNDIT	112
12 NËNTOR 1987	113
10 QERSHOR 2000	114
INSTIKT VETMIE	116
98 VITET E TUA	117
TEATRI I QYTETIT TË VOGËL	118
NË GJAKOVË	120
MOTRA E VETME	121
MË THOSHTE GJYSHI	122
SMS NGA DANTJA	123
FRYMËZIM NGA KIPLING	124



Azem Baliaj

Botime

"Helmuar nga dashuria", *lirika*, 2002

"Hamleti në asistencë", *satira*, 2004

"Fishta në Lissus", *poemë-ese*, 2011

"Papuruse dashurie", *poezi*, 2018

Për skenën

"Trimëritë e Zollumit", *komedi*, 1978

"Të pyesim zemrat", *komedi*, 1980

"Me porosi të estradës", *skeçe*, 1983

"Ngjarje në pranverë", *dramë*, 1983

"Të kesh autoritet", *dramë*, 1985

"Vjehrra jashtë loje", *komedi*, 1989

"Fytyra e tretë", *komedi*, 1991

"Lajmthirrje nga Amerika", *komedi*, 1993

"Miss Lissus 2005", *spektakël TV*, 2005

"Mbrëmje Fishtiane", *spektakël TV*, 2005

"Skënderbeu i ofenduar", *komedi*, 2005

"Teatri i qytetit", *monodramë*, 2009

